

# Pjesëmarrja e fëmijëve

---

Nga Paul Stephenson

Me Steve Gourley dhe Glenn Miles

Shqipëroi: Florenc Mene



# Përmbajtja

## Pjesa 1

<b>HYRJE</b> .....	<b>5</b>
<b>FJALORTH</b> .....	<b>7</b>
<b>HYRJE PËR PJESËMARRJEN E FËMIJËVE</b> .....	<b>9</b>
1.1. Një pikëpamje biblike për fëmijët .....	9
1.2. PSE PJESËMARRJA E FËMIJËVE? .....	11
1.3. Shqyrtimi i pjesëmarrjes .....	12
▪ Tipat e pjesëmarrjes .....	12
▪ Rrota e pjesëmarrjes .....	13

## Pjesa 2

<b>PËRGATITJA PËR PJESËMARRJE</b> .....	<b>17</b>
-----------------------------------------	-----------

## Pjesa 3

<b>INTEGRIMI I PJESËMARRJES SË FËMIJËVE NË JETËN E KOMUNITETIT</b> .....	<b>23</b>
▪ Klubet e fëmijëve .....	23
▪ Lëvizjet dhe rrjetet e fëmijëve .....	25
▪ Këshillat e fëmijëve .....	26
▪ Parlamentet e fëmijëve .....	27

## Pjesa 4

<b>PJESËMARRJA E FËMIJËVE NË CIKLIN E PROJEKTIT</b> .....	<b>28</b>
4.1. Identifikimi i projektit .....	29
▪ Mjetet e vlerësimit të nevojave .....	29
4.2. Plani i projektit .....	37
▪ Analiza e palës së interesit .....	37
▪ Puna kërkimore me fëmijët .....	38
4.3. Zbatimi dhe vlerësimi .....	46
4.4. Festimi dhe dokumentimi i mësimëve të marra .....	51

## Pjesa 5

<b>BURIMET</b> .....	<b>53</b>
----------------------	-----------

## Shtojcë

<b>MBROJTJA E FËMIJËVE</b> .....	<b>56</b>
----------------------------------	-----------



# HYRJE

Pjesëmarrja e fëmijëve mund të përcaktohet si: “Fëmijët ndikojnë në çështjet që u prekin jetën, duke ngritur zërin ose duke hyrë në veprim e në partneritetet me të rriturit.” Energjia pas pjesëmarrjes së fëmijëve vjen nga:

- theksimi në rritje i të drejtave të fëmijëve;
- praktika e mirë e zhvillimit të komunitetit, e cila u bën të mundur njerëzve që të trajtojnë problemet e tyre.

Ky libër i përcakton fëmijët si njerëz të moshave nga 0 deri në 18 vjeç. Shkalla e pjesëmarrjes së fëmijëve do të varet nga moshja, nga përvoja dhe nga pjekuria e fëmijës. Nuk mund të presim që foshnja të marrë vendime logjike dhe nuk duhet të presim që një fëmijë shtatëvjeçar të ndërmarrë barrën dhe përgjegjësitë e një të rrituri. Sidoqoftë, të gjithë fëmijët duhet të përfshihen dhe të konsultohen në njëfarë mënyre me çështjet që u prekin jetën. Ky libër fokusohet te fëmijët e moshave nga 6 deri në 18 vjeç.

Fëmijët janë njerëz me dinjitet. Pikëpamjet e tyre duhen dëgjuar dhe respektuar njësoj si ato të të rriturve. Pjesëmarrja e fëmijëve mund të mundësojë që projektet e zhvillimit të përmbushin nevojat e të gjithëve në komunitet. Shpesh fëmijët duan të marrin pjesë, por të rriturit nuk i lejojnë. Kjo mund të vijë për shkak të perceptimeve kulturore dhe sociale, sikur gjoja fëmijëve u mungojnë aftësitë dhe janë të paaftë të shprehin mendimet. Ekziston edhe frika se mos fëmijët bëhen tepër të pavarur dhe nuk i respektojnë të rriturit.

Pjesëmarrja e fëmijëve nuk është diçka që duhet bërë vetëm për shkak se sot është në modë. Ky libër tregon se pjesëmarrja e fëmijëve është pjesë thelbësore e praktikës së mirë zhvillimore. Përfshirja e fëmijëve në projekte zhvillimi dhe në jetën e komunitetit mund të zbulojë perspektiva të reja mbi problemet, të krijojë më tepër unitet dhe besim brenda komunitetit, si dhe të zhvillojë aftësitë e brezit të ri të drejtuesve dhe të anëtarëve të komunitetit. Pjesëmarrja e fëmijëve mund të sigurojë rrënjët për një zhvillim të qëndrueshëm.

Ky libër shqyrton pjesëmarrjen e fëmijëve dhe mënyrën si mund të lehtësohet ajo; përshkruan përvoja të pjesëmarrjes së suksesshme të fëmijëve dhe jep ide e mjete që mund të ndihmojnë organizatat në punën e tyre me fëmijët. Këto përshkruhen brenda një kornize cikli projekti për të ndihmuar organizatat që të integrojnë pjesëmarrjen e fëmijëve në planifikimin e tyre. Ai mund të përdoret bashkë me *ROOTS 5: Project cycle management (Menaxhimi i ciklit të projektit)*.



# FJALORTH

Ky fjalorth shpjegon kuptimin e fjalëve të vështira sipas mënyrës që janë përdorur në këtë libër.

<b>Përkrah</b>	Të ngresh zërin për një çështje para pushtetarëve.
<b>Niveli standard</b>	Të dhëna që përdoren si referencë me të cilën të mund të krahasohen rezultatet ose ndikimi i ardhshëm.
<b>Ide e çastit</b>	Të shprehësh çfarëdo që të vjen aty për aty në mendje në lidhje me një çështje.
<b>Fëmijë</b>	Person i moshës 0 deri 18 vjeç. Në këtë libër, ne përqendrohemi të fëmijët e moshave 6 deri 18 vjeç.
<b>Detyrim</b>	Përdorimi i trysnisë për të detyruar njerëzit që të bëjnë gjëra që s'duan t'i bëjnë.
<b>Bashkëpunoj</b>	Punoj së bashku për të arritur diçka.
<b>Këshill</b>	Grup njerëzish që janë zgjedhur ose caktuar për të këshilluar ose marrë vendime në emër të të tjerëve.
<b>Grup fokusi</b>	Grup i vogël njerëzish që përdorin njohurinë ose interesin e tyre specialist për të diskutuar për një çështje të veçantë.
<b>Bucela</b>	Pjesa qendrore e rrotës që mban rrezet e rrotës dhe montohet te pjesa kryesore e mjetit lëvizës.
<b>Infrastruktura</b>	Sistemet, shërbimet dhe ambientet, që janë të nevojshme për aktivitet ekonomik, si: rrugët, transporti dhe shkollat.
<b>Bëj lobing</b>	Përpiqem të ndikoj në politika përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me politikëbërësit.
<b>Struktura logjike</b>	Tabela që jep një përmbledhje të planeve të projektit (objektivat, treguesit, faktet dhe supozimet).
<b>Murale</b>	Pikturë e madhe e pikturuar drejtpërdrejt mbi mur.
<b>OJQ</b>	Organizatë joqeveritare – një organizatë që menaxhohet në mënyrë të pavarur nga qeveria.
<b>Pançajat</b>	Këshill fshati në Indi.

<b>Parlament</b>	Grup njerëzish të zgjedhur me përgjegjësi vendimmarrëse, ku gjithsecili prej tyre përfaqëson një rajon ose grup të caktuar.
<b>Pjesëmarrje</b>	Përfshirja e njerëzve në vendimet dhe proceset që u prekin jetën, përfshi këtu shkëmbimin e informacionit, konsultimin, menaxhimin, vendimmarrjen dhe kryerjen e veprimeve.
<b>NVP</b>	Nxënie dhe veprim pjesëmarrës.
<b>Pornografi</b>	Filma, revista, fotografi dhe materiale të tjera që prodhohen për të shkaktuar nxitje seksuale.
<b>Pyetësor</b>	Grup pyetjesh që përdoren për të mbledhur informacion për një anketim.
<b>Rep</b>	Fjalë të shprehura me ritëm me muzikë pop.
<b>Rrezet</b>	Shkopinj mbështetës mes gomës dhe bucelës (pjesës qendrore) së rrotës.
<b>Pala e interesit</b>	Personi që ka interes ose preokupim për një projekt që po kryhet nga një organizatë.
<b>Anketim</b>	Analizë e kujdesshme e një situatë ose e pikëpamjeve dhe e mendimeve të njerëzve.
<b>Simbolikë</b>	Kryerja e një përpjekjeje simbolike ose kryerja e një reagimi të kufizuar për të arritur diçka.
<b>Trafikimi</b>	Tregtia e paligjshme.
<b>UNCRC</b>	<i>United Nations Convention on the Rights of the Child</i> (Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve).



# Hyrje për pjesëmarrjen e fëmijëve

## 1.1. Një pikëpamje biblike për fëmijët

Në shumë kultura fëmijët nënvlerësohen. Mirëpo Perëndia i vlerëson fëmijët po aq sa dhe të rriturit. Të gjitha qeniet njerëzore janë krijuar në shëmbëlltyrën e tij.

### STUDIM BIBLIK

#### Pikëpamja e Perëndisë për fëmijët

- Lexo Zanafillën 1:26-27.
  - Çfarë thonë këto vargje për vlerën e njerëzve në sytë e Perëndisë?
  - A i vlerëson Perëndia fëmijët ndryshe nga të rriturit?
  - Si na inkurajojnë këto vargje që të respektojmë të rriturit dhe fëmijët?
- Lexo Ligjin e përtërirë 7:11-14.
  - Çfarë thonë këto vargje për mënyrën si i vlerëson fëmijët Perëndia?
- Lexo Psalmin 127 dhe Psalmin 128.
  - Çfarë fjalësh përdoren në këto psalme për të përshkruar pikëpamjen e Perëndisë për fëmijët?
  - A i shikojmë gjithmonë fëmijët si bekim?
- Si shihen fëmijët në kulturën tonë?
- Në çfarë mënyrash praktike mund të inkurajojmë njerëzit që na rrethojnë, që t'i shohin fëmijët ashtu siç i shikon Perëndia?

Perëndia e bën të qartë se fëmijët janë të varur dhe e përdor këtë për t'u mësuar të rriturve mbretërinë e Perëndisë.

### STUDIM BIBLIK

#### Qëndrimi i Jezusit ndaj fëmijëve

- Lexo Mateun 18:1-6 dhe 19:13-15.
- Këto vargje tregojnë se Jezusi mbante një qëndrim pozitiv ndaj fëmijëve. Sidoqoftë, mësimi i këtyre vargjeve është edhe më i thellë.
- Cili është dallimi mes fëmijëve dhe të rriturve për sa i përket varësisë?
  - Kur mëkatojmë, i kthejmë kurrizin Perëndisë dhe duam që të ecim në udhën tonë. Atëherë, pse kemi nevojë të bëhemi si fëmijë për të hyrë në mbretërinë e Perëndisë?
  - Çfarë paralajmërimi dha Jezusi për ata që i çojnë fëmijët në udhën e gabuar?

## STUDIM BIBLIK

Bibla e vendos mbi familjen përgjegjësinë për rritjen e fëmijëve. Në mënyrë ideale, kjo duhet të kryhet brenda familjes ose fisit, por, atje ku s'është e mundur, përgjegjësinë duhet ta marrë familja e besimtarëve (kisha) (Eksodi 22:22; Jakobi 1:27).

## Zhvillimi tërësor i fëmijëve

- Lexo Llukën 2:40-52.

Këto vargje përshkruajnë mënyrën si u rrit Jezusi dhe tregojnë zhvillimin e përsosur njerëzor nga fëmijëria deri në moshën e pjekurisë.

- Çfarë thotë ky pasazh për zhvillimin e Jezusit nga ana: intelektuale, fizike, shpirtërore dhe shoqërore?
- A e mendojmë gjithmonë në këtë mënyrë zhvillimin e fëmijës?
- Çfarë roli luajtën të rriturit në fëmijërinë e Jezusit?

- Lexo Mateun 21:14-16.

- Çfarë thotë ky pasazh për aftësinë e fëmijëve që të dallojnë se kush është Jezusi dhe t'i përgjigjen?
- A i shohim gjithmonë këto aftësi te fëmijët në kishën tonë?

Çfarë mund të bëjmë për të nxitur zhvillimin e fëmijëve në familjet dhe në komunitetet tona?

Bibla mëson se marrëdhëniet e të rriturve me fëmijët duhet të jenë: plot dashuri, të drejta dhe me bazë respektin. Ajo i nxit prindërit ose kujdestarët që të disiplinojnë fëmijët që kanë nën përkujdesje. Kjo u lejon fëmijëve që të eksplorojnë mjedisin që i rrethon brenda një numri caqesh të sigurta dhe të shëndetshme.

## STUDIM BIBLIK

## Edukimi i fëmijëve

Ka shumë gjëra që duhet të marrim parasysh kur përpiqemi të edukojmë fëmijët:

- Lexo Ligjin e përtërirë 4:9-10; 6:5-7; Fjalët e urta 4; 22:6; Efesianët 6:1-4.
  - Çfarë dobie ka kur u mësojmë fëmijëve për karakterin e Perëndisë, për atë që ka bërë Jezusi për ne dhe për mënyrën si të jetojnë si populli i Perëndisë?
- Lexo Hebrenjve 12:7-11; Fjalët e urta 13:24, 29:15 dhe 29:17.
  - Pse na dispijton Perëndia si fëmijë të tij?
  - Çfarë dobie ka disiplina për fëmijët tanë?
  - Si mund t'u jepet fëmijëve një disiplinë që i edukon, por që nuk i abuzon?
  - Çfarë formash disipline përdoren në kulturën tonë? Cilat prej tyre mendojmë se janë të përshtatshme, dhe pse?
- Lexo Kolosianët 3:21.
  - Si mund të shmangim pezmatimin e fëmijëve?
  - Në çfarë mënyrash mund t'i inkurajojmë?
  - Në çfarë zonash të jetës mund t'i inkurajojmë?

Si përmbledhje themi: “Fëmijët janë bekim nga Perëndia.” Ata duhen edukuar në një mjedis të mbrojtur, në mënyrë ideale brenda një situatë familjare, për t’iu mundësuar që të fitojnë pavarësi, t’i shërbejnë Perëndisë dhe të tjerëve dhe për të arritur potencialin që u ka dhënë Perëndia.

## 1.2. Pse pjesëmarrja e fëmijëve?

Me qëllim që të inkurajojmë fëmijët t’u shërbejnë të tjerëve, është e nevojshme të sigurohemi që ata të marrin pjesë në jetën e familjes, të kishës dhe të komunitetit.

Jo vetëm që duhet të kujtojmë bazën biblike për përfshirjen e fëmijëve, por duhet të jemi të vetëdijshëm edhe për arsyet ligjore dhe logjike për inkurajimin e pjesëmarrjes së fëmijëve.

- Sipas ligjit ndërkombëtar, fëmijët kanë të drejtë të konsultohen për të gjitha vendimet në lidhje me jetën e tyre. Shumica e vendeve kanë nënshkruar konventën e Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e fëmijëve”. Sipas nenit 12 të konventës, fëmijëve u duhet kërkuar të japin mendimin e tyre për të gjitha çështjet që i prekin, përfshi dhe procedurat ligjore dhe administrative. Kjo duhet të marrë parasysh *moshën* dhe *pjekurinë e fëmijës*.
- Fëmijët dinë shumë gjëra për jetën e tyre. Shpesh, për jetën e fëmijëve, merren vendime në bazë të informacionit që sigurohet vetëm nga të rriturit. Mirëpo të rriturit nuk mund të mendojnë, të ndiejnë dhe të shohin jetën si fëmijët. Shpesh të rriturit bëjnë supozime se ç’lloj informacioni janë ose nuk janë në gjendje të sigurojnë fëmijët. Nëse të rriturit nuk i dëgjojnë fëmijët, vendimet që ata marrin për fëmijët mund të kenë një ndikim negativ, jopozitiv. Mund të hartohen metoda të ndryshme, që fëmijët ta kenë të lehtë të japin informacion. Informacioni i siguruar nga fëmijët mund të përdoret së bashku me informacionin që sigurohet nga të rriturit.

Familja është mjedisi i natyrshëm ku fëmijët rriten dhe kanë mirëqenie. Megjithatë, për shkak të trysnive me të cilat përballen familjet në mbarë botën, shumë fëmijë rriten me një ose me asnjë prind, ose në situata abuzimi dhe shpërfilljeje. Kjo mund të çojë në situatën ku fëmijët marrin përsipër përgjegjësinë për të siguruar motrat dhe vëllezërit ose detyrohen të jetojnë në rrugë për të shmangur dhunën dhe varfërinë në shtëpi. Atyre u duhet të bëhen të pavarur më herët se fëmijët e tjerë. Pjesëmarrja në jetën e komunitetit bëhet tejet e rëndësishme për këta fëmijë. Ata duhet të jenë në gjendje të marrin vendimet e duhura dhe të mbrojnë veten.

Një nga rolet e organizatave të zhvillimit është të bëjnë të mundur që fëmijëve t’u jepet mundësia për të marrë pjesë. Kjo mund të përfshijë:

- Aftësimin e familjeve që të kujdesen për fëmijët dhe t’ua vënë veshin.
- Dhënien e një mundësie që fëmijët të marrin pjesë në jetën e komunitetit, si për shembull, ndihma që mund t’u jepet për të ngritur një klub ose këshill fëmijësh.
- Pjesëmarrjen e fëmijëve si palë interesi në të gjithë tipat e projekteve të zhvillimit

komunitar.

- Zhvillimin e projekteve me fëmijët që mund të mos kenë familje që kujdeset për ta.
- Aftësimin e fëmijëve që të paraqesin preokupimet e tyre në konferenca ose konsultime në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.

Të gjithë fëmijëve u duhet dhënë mundësia për të marrë pjesë, por, shpesh, disa fëmijë, përjashtohen për shkak të gjinisë, të paaftësisë fizike ose të grupit të tyre etnik. Për shembull, vajzave u duhen dhënë po aq mundësi sa edhe djemve që të marrin pjesë.

### 1.3. Shqyrtimi i pjesëmarrjes

Është e nevojshme të shqyrtojmë veten dhe rolet tona në lidhje me fëmijët, me qëllim që ata të përfshihen në planifikimin dhe zbatimin e projekteve edhe në jetën e komunitetit. Duhet të sigurojmë një drejtpeshim mes tipit dhe cilësisë së pjesëmarrjes që ndodh. Fëmijët duhen përfshirë në një mënyrë që respekton dhe mbështet rolet e tyre si vendimmarrës. Kjo detyrë nuk është e lehtë. Së pari, do të shqyrtojmë tipin e përshtatshëm të pjesëmarrjes për aspekte të ndryshme të punës sonë me fëmijët. Më pas do të shqyrtojmë rrotën e pjesëmarrjes, e cila na ndihmon të mendojmë për elementet që nevojiten për pjesëmarrjen e efektshme dhe me cilësi të mirë nga ana e fëmijëve.

#### TIPAT E PJESËMARRJES

Ekzistojnë disa lloj pjesëmarrjeje. Diagrami i mëposhtëm tregon se cilët janë këta tipa. Simbolika është niveli më i ulët i pjesëmarrjes, ku fëmijët përfshihen në njëfarë mënyre, por jo në mënyrë të ndjeshme. Tipi i pestë i pjesëmarrjes është pjesëmarrja më autentike nga ana e fëmijëve, ku ata marrin rolin kryesor. Kjo do të thotë se ata kanë fuqi vendimmarrëse të përcaktuara qartë brenda një strukture të miratuar, si për shembull brenda një klubi fëmijësh. Kjo nuk do të thotë se ata janë nën kontroll ose në një pozitë ku mund të anashkalojnë këshillat e të rriturve, që mund të jenë në interesin e tyre më të mirë.

Mund të duhet kohë që fëmijët të ndihen rehat me një nivel më të lartë pjesëmarrjeje. Disa mund të mos duan që ta marrin këtë përgjegjësi dhe mund të bien dakord që të lejojnë të rriturit të marrin drejtimin në momente të ndryshme. Ne mund të vendosim të punojmë në nivele të ndryshme pjesëmarrjeje për aktivitete të ndryshme. Sidoqoftë, është e rëndësishme që stafi dhe fëmijët të punojnë së bashku për të sjellë ndryshim.

## 5. MARRJA E NJË ROLI KRYESOR – “Veprim nga”

**ME NISMËN DHE ME DREJTIMIN E FËMIJËVE.** Fëmijët përcaktojnë axhendën dhe janë aktivë nga ana politike.

## 4. BASHKËPUNIMI DHE PARTNERITETI – “Veprim me”

**ME NISMËN E TË RRITURVE, VENDIME TË MARRA SË BASHKU ME FËMIJËT.** Të rriturit kanë idenë fillestare, por fëmijët përfshihen në çdo hap të planifikimit dhe të zbatimit.

**ME NISMËN E FËMIJËVE, VENDIME TË MARRA SË BASHKU ME TË RRITURIT.** Fëmijët dhe organizatat e tyre ftojnë të rriturit të bashkëpunojnë me ta. Rolet përcaktohen së bashku.

**ME NISMËN E PËRBASHKËT TË FËMIJËVE DHE TË RRITURVE.** Fëmijët dhe të rriturit punojnë në partneritet për të rënë dakord dhe së bashku drejt synimeve të përbashkëta.

## 3. KONSULTIMI – “Veprim me/nga”

**FËMIJËT KONSULTOHEN DHE INFORMOHEN.** Projekti hartohet dhe drejtohet nga të rriturit duke përdorur sugjerimet dhe preokupimet e fëmijëve. Fëmijët informohen në mënyrë që të mund të marrin vendimet e duhura.

## 2. INFORMIMI – “Veprim për”

**FËMIJËVE U JEPET NJË DETYRË DHE U THUHET SE ÇFARË KËRKOHEM PREJTYRE.** Fëmijët informohen dhe janë dakord për veprimet që ndikojnë te ata. Ata mund të jenë në gjendje të zgjedhin që të kryejnë detyrën.

## 1. DETYRIMI - “Veprim mbi”

**MANIPULIMI.** Fëmijët bëjnë ose thonë atë që duan të rriturit, por nuk i kuptojnë vërtet çështjet. Nga ana tjetër, fëmijët mund të pyeten se çfarë mendojnë, por pastaj të rriturit përdorin disa ide pa u treguar fëmijëve se çfarë ndikimi kanë pasur mbi vendimin përfundimtar.

**ZBUKURIMI.** Fëmijët marrin pjesë në një eveniment, si për shembull me këngë ose me kërcime, por s’kanë ndikim mbi mënyrën si organizohet.

**SIMBOLIKA.** Fëmijëve u kërkohet mendimi, por kanë fare pak mundësi zgjedhjeje për mënyrën si mund t’i shprehin ato pikëpamje ose gamën e ideve që mund të shprehin.

### Reflektim

- Mendoni për shembuj të pjesëmarrjes së fëmijëve që kemi parë në secilin prej këtyre niveleve.
- Çfarë mund të ishte bërë ndryshe për t’u mundësuar fëmijëve të merrnin pjesë në mënyrë më të plotë?

## RROTA E PJESËMARRJES

Rrota e pjesëmarrjes na ndihmon që të sigurohemi se pjesëmarrja e fëmijëve është e efektshme. Rrota ndërtohet nga disa rreze mbështetëse që ngjiten rreth një bucele. Rrezja duhet të drejtpeshohet dhe ta mbajë rrotën plotësisht të rrumbullakët, në mënyrë që ajo të rrotullohet mirë. Rrota e pjesëmarrjes përbëhet nga tri rreze: parimet e mundësisë,

përgjegjësish dhe mbështetjes. Secila prej këtyre rrezeve është e nevojshme për të mbështetur fëmijët në procesin e pjesëmarrjes siç e tregon edhe diagrami i mëposhtëm. Bucela përfaqëson respektin, i cili formon bazën e tri parimeve.

Nëse fëmijëve nuk u sigurohet gjithmonë respekti, mundësia, përgjegjësia dhe mbështetja, pjesëmarrja e tyre do të jetë e padrejtpeshuar dhe do të ngadalësohet, ashtu siç ndikon rrezja e thyer ose goma e shpuar në lëvizjen e biçikletës. Kur fëmijëve u jepet respekt, mundësi, përgjegjësi dhe mbështetje, ata janë në gjendje të marrin pjesë në një mënyrë që ua rrit kapacitetin dhe efektivitetin në vendimmarrje. Nga ana e saj, kjo gjë do të mundësojë që ata të marrin pjesë në mënyrë më kuptimplotë.

### Rrota e pjesëmarrjes



Bucela dhe rrezet e rrotës së pjesëmarrjes përshkruhen më poshtë. Është mirë që të reflektoni në lutje për këto parime. Pastaj mendoni për mënyra praktike se në ç'mënyrë mund të zbatohen në punën specifike me fëmijët.

### Jepuni fëmijëve respekt

**Respekti** është thelbësor, sepse siguron mbështetje për tri parimet ose rrezet që plotësojnë rrotën e pjesëmarrjes. Nëse s'ka respekt, bëhet e vështirë që të vihen në veprim këto tri parimet. Respekti mund të tregohet duke dëgjuar atë që thonë fëmijët, duke u kërkuar mendim, duke u shpjeguar vendimet dhe veprimet dhe duke u dhënë të gjithë fëmijëve trajtim të njëjtë, pavarësisht nga gjuha dhe aftësitë.

Shpesh njerëzit që e konsiderojnë veten *profesionistë* ose *ekspertë*, e kanë të vështirë t'u kërkojnë fëmijëve ide ose zgjidhje. Kjo mund të ndodhë për shkak të qëndrimeve dhe përvojave negative dhe është pengesë e madhe për organizatat që dëshirojnë të lehtësojnë pjesëmarrjen e fëmijëve. Për ta kaluar këtë pengesë dhe për të nxitur respektin ndaj fëmijëve, duhet të kërkojmë dhe të vlerësojmë pikat e forta dhe sukseset e tyre.

### Jepuni fëmijëve mundësi

Fëmijëve u duhen dhënë **mundësi** që të përdorin aftësinë që u ka dhënë Perëndia për të reaguar ndaj çështjeve që i prekin. Një nga pengesat më të mëdha për zbatimin e këtij parimi është qëndrimi që kanë disa të rritur ndaj fëmijëve.

Fëmijëve mund t'u jepen mundësi që të marrin pjesë në faza të ndryshme të ciklit të projektit. Për shembull:

### Jepuni fëmijëve përgjegjësi

### Jepuni fëmijëve mbështetje

- **IDENTIFIKIMI I PROJEKTIT** – Përfshini fëmijët në kryerjen e vlerësimeve të nevojave të situatës ku ndodhen.
- **PLANI I PROJEKTIT** – Mblidhni ide dhe informacione nga fëmijët për reagimet ndaj problemeve).
- **ZBATIMI DHE VLERËSIMI** – Mbështetni fëmijët kur marrin pjesë në aktivitetet e projektit, monitoroni dhe shqyrtoni përparimin e tyre, si dhe vlerësoni ndikimin e tyre.
- **PËRGËZIMI PËR SUKSESIN DHE NXËNIA E MËSIMEVE** – Lejoni fëmijët që të reflektojnë për (dhe të regjistrojnë) atë që mund të mësohet nga projekti).

Në secilën prej këtyre fazave, fëmijëve mund t'u jepet mundësia që të ndajnë idetë e tyre dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive. Tipi i pjesëmarrjes mund të ndryshojë. Për shembull, mund të lëvizë, sipas nevojës, mes **konsultimit** dhe **bashkëpunimit** dhe në përputhje me moshën, me përvojën dhe me aftësitë e tyre. Fëmijët mund të drejtojnë vlerësimet e nevojave të tyre në fazën e identifikimit të projektit. Në fazën e planit të projektit, të rriturit mund të konsultohen me fëmijët për ide, për aktivitete dhe për reagime të mundshme.

Në të gjitha rastet duhen përdorur metoda që përfshijnë fëmijët. Për shembull, përdorimi i arteve krijuese, si: vizatimet, fotografitë dhe dramat, është shumë i efektshëm për të lejuar fëmijët që të ndajnë idetë dhe mendimet e tyre, në mënyrë zbatimëse dhe jokërcënuese, për çështje që i prekin. Pjesa e 4-t shqyrton në më tepër detaje ciklin e projektit dhe metodat që përfshijnë fëmijët.

Nëse fëmijëve u jepet **përgjegjësi**, ata gradualisht do të bëhen të aftë si vendimmarrës; nëse fëmijëve u lejohej të marrin vendime dhe të marrin pjesë në rrjedhojat, kjo ndihmon në rritjen dhe në përvojën e tyre që të ndikojnë në aktivitete projekti ose veprime të komunitetit, ose t'i drejtojnë ato. Është jetike për rritjen dhe mirëqenien e fëmijëve që të mësojnë si të reagojnë në mënyrë aktive ndaj çështjeve që u prekin jetën si në mënyrë individuale, ashtu edhe kolektive.

Tipat dhe nivelet e vendimmarrjes dhe përgjegjshmërisë duhet të jenë realistë dhe të përshtatshëm për moshën dhe pjekurinë e fëmijëve, duke u rritur me kalimin e kohës teksa fëmijët rriten dhe fitojnë përvojë. Fëmijët duhet të kuptojnë plotësisht rrjedhojat e vendimeve të tyre. Ata duhet të bien dakord për përgjegjësitë e tyre me të rriturit para se të fillojë projekti ose aktiviteti.

Parimi i tretë i nevojshëm për të siguruar pjesëmarrjen e efektshme të fëmijëve është **mbështetja**. Kur fëmijët respektohen aq sa duhet për t'u dhënë **mundësinë** për të ndikuar ose drejtuar aktivitetet dhe **përgjegjësinë** për të marrë vendime, ata duhen **mbështetur** në mënyrë që të jenë të suksesshëm.

Pjesëmarrja është një proces që kërkon kohë dhe siguri besimi, që fëmijët ta mësojnë dhe t'i bashkohen. Si rezultat, ata duhen mbështetur në mënyra të ndryshme. Kjo mund të jetë e vërtetë sidomos për fëmijët që nuk kanë pjekuri ose përvojë, që kanë sfida fizike ose nxënieje, ose që po përballen me vështirësi të rënda emocionale.

Shumica e fëmijëve do të kenë nevojë për tipa të ndryshëm mbështetjeje. Zakonisht këtu përfshihen sigurimi i informacionit të ri ose shtesë, i aftësive, i materialeve ose i burimeve financiare. Fëmijët nuk mund të marrin vendime të sakta, nëse nuk u paraqitet një informacion i përditësuar në mënyrë që të mund ta kuptojnë. Për këtë informacion mund të përdoren librat, regjistrimet audio dhe afishet.

E rëndësishme është të plotësohen edhe nevojat emocionale. Të rriturit duhet t'u sigurojnë fëmijëve ngushëllim, inkurajim dhe përgëzim, me qëllim që të zhvillohet një ndjesi krenarie dhe arritjeje. Atmosfera ku fëmijët marrin pjesë duhet të jetë miqësore dhe e qetë. Kjo u mundëson atyre që janë të turpshëm ose të ndrojtur të gjejnë mënyra si të shprehen.

### Çfarë përfshin ose nuk përfshin pjesëmarrja e fëmijëve

Pavarësisht nga dobitë e përfshirjes së fëmijëve në planifikimin e projekteve, kjo s'është zgjidhje e lehtë kur vjen puna te planifikimi i projekteve të suksesshme. Në vitin 2002, fëmijë aktivë dhe menaxherë programesh në Azi u mblodhën për të përcaktuar çfarë ishte nxënë në lidhje me pjesëmarrjen e fëmijëve në rajonin e tyre. Tabela e mëposhtme është një përmbledhje e dobishme mbi atë që të dyja palët ranë dakord në lidhje me pjesëmarrjen e fëmijëve.

PJESËMARRJA E FËMIJËVE	
PËRFSHIN:	NUK PËRFSHIN:
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ njohjen e vlerës së njohurive dhe të kontributeve të fëmijëve,</li> <li>▪ shkëmbimin e përvojës dhe të ekspertizës me fëmijët,</li> <li>▪ nxënien nga fëmijët,</li> <li>▪ gjetjen e mënyrave për t'ua bërë të lehtë fëmijëve marrjen e vendimeve dhe zbatimin e tyre,</li> <li>▪ ndihmën që u duhet dhënë fëmijëve dhe të rriturve që të kuptojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre,</li> <li>▪ ndarjen e pushtetit me fëmijët,</li> <li>▪ punën për të krijuar respekt për të drejtat e qytetarëve më të rinj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ sugjerimin që u jepet fëmijëve se çfarë duhet të mendojnë ose thonë,</li> <li>▪ mendimin se të rriturit nuk kanë ç'të mësojnë,</li> <li>▪ zhvlerësimin e përvojës dhe të ekspertizës së të rriturve,</li> <li>▪ përdorimin e fëmijëve për të kryer punën e të rriturve,</li> <li>▪ asnjë të drejtë për të rriturit dhe asnjë përgjegjësi për fëmijët,</li> <li>▪ dorëzimin e të gjithë pushtetit në duart e fëmijëve,</li> <li>▪ ruajtjen e gjendjes së tanishme të gjërave.</li> </ul>

#### Reflektim

- A jemi dakord me pohimet mbi atë që përfshin ose nuk përfshin pjesëmarrja e fëmijëve?
- Sa shpesh i vëmë në praktikë pohimet pozitive në punën tonë?
- A ka pohime të tjera që duhet të shtojmë?

Marrë nga Grupi Rajonal i Punës për Punën e Fëmijëve, 2003.



# Përgatitja për pjesëmarrje

Të rriturit duhen përgatitur nga ana emocionale dhe shoqërore për të pranuar dhe për të mbështetur plotësisht pjesëmarrjen e fëmijëve. Kjo ndodh për shkak se bindjet dhe pritshmëritë e zakonshme kulturore në lidhje me rolet e fëmijëve dhe të rriturve mund të sfidohen kur fëmijëve u jepen mundësi për të marrë pjesë. Shpesh të rriturit kanë pasur përvoja personale që ua kanë formuar pikëpamjet dhe sjelljen kundrejt fëmijëve. Është thelbësore që përqsasjet e dëmshme të zëvendësohen me ide të reja pozitive për atë që është e mundur dhe e përshtatshme që të thonë dhe të bëjnë fëmijët.

Përpara se të inkurajohet pjesëmarrja e fëmijëve në komunitetet dhe në projektet tona, duhen ndërmarrë një numër hapash. Kjo përgatitje na përfshin vetë ne si të rritur, komunitetin, vetë fëmijët, si dhe organizatën tonë.

## Përgatitni të rriturit

Të rriturit që dëshirojnë të lehtësojnë pjesëmarrjen e fëmijëve, duhet të mësojnë të pranojnë kapacitetin e çdo fëmije që të zhvillojë veten dhe botën e vet. Po kështu, ata duhet të mposhtin frikën që kanë për të mos u dhënë fëmijëve gjithnjë e më tepër mundësi, përgjegjësi dhe ndikim – role që tradicionalisht janë luajtur vetëm nga të rriturit. Kjo mund të kërkojë kohë.

Disa mënyra për të ndihmuar të rriturit që të përgatiten për pjesëmarrje janë:

### Trajtoni përqsasjet negative

Pranoni dhe trajtoni çdo mendim ose pikëpamje negative për fëmijët, që mund të ndikojë në atë që presin të rriturit prej tyre. Në veçanti, tregohuni të vetëdijshëm për pikëpamjet negative që mbahen rëndom, për shembull: “Fëmijët s’dinë asgjë”; “Fëmijët e rrugës janë të pasjellshëm dhe të pandershëm.” Meqë këto pikëpamje mund të bëhen pjesë e kulturës sonë, shpesh ato mbahen nga individit në nivelin e nënvetëdijshëm dhe emocional. Si rrjedhojë, mund të jetë e vështirë të zbulohen. Kaloni kohë në reflektim të ndershëm për të identifikuar pikëpamjet negative. Mendoni për mënyrën si ato mund të prekin punën me fëmijët dhe mënyrën si ato pikëpamje mund të zëvendësohen me pikëpamje më të sakta dhe pozitive. Mund të jetë e dobishme të mendoni për kohën kur ishim fëmijë dhe për mënyrën si të rriturit reagonin ndaj nesh, si në mënyrë pozitive, ashtu dhe negative.

### Çmoni individin

Përvojat negative me fëmijët në të shkuarën mund të prekin së tepërmi qëndrimet e të rriturve ndaj fëmijëve dhe ndërveprimet me ta në të tashmen. Për shembull, ndoshta përvojat me fëmijë kanë çuar në zhgënjim ose pezmatim. Çdo fëmijë është unik dhe meriton mundësinë që të shihet si individ, pa u krahasuar me dikë tjetër. Mos lejoni përvojat e kaluara me fëmijët që të ndikojnë në mënyrën si shihet ose trajtohet një fëmijë i ri ose grup i ri fëmijësh.

### Fokusohuni te pikat e forta

Ndoshta mënyra më e mirë që i rriturit të përgatitet për pjesëmarrjen e fëmijëve është t’i vlerësojë si duhet shumë talente, dhunti dhe kontribute që kanë fëmijët. Kjo mund të jetë tejet e vështirë për njerëz që janë mësuar të drejtojnë dhe të disiplinojnë fëmijët dhe

të cilët, si rezultat, mund të fokusohen te të metat dhe dobësitë. Kërkimi dhe pranimi i krijueshmërisë, mendjemprehtësisë dhe arritjeve të fëmijëve në jetën e tyre të përditshme do të rrisë besimin dhe vetësigurinë në aftësinë e tyre për t'u përballur me përfshirje dhe përgjegjësi të mëtejshme. Të rriturit që përqendrohen te pikat e forta dhe arritjet i mundësojnë dhe i mbështesin fëmijët që të marrin pjesë në mënyrë më të plotë.

## Reflektim

- Çfarë qëndrimesh negative kam kundrejt fëmijëve?
- Cili është burimi i këtyre qëndrimeve?
- Cilat janë rrjedhojat e këtyre qëndrimeve?
- Si mund t'i trajtoj këto qëndrime?
- Çfarë hapash praktikë mund të marr?
- Çfarë pikash të forta shoh te fëmijët që njoh në mënyrë individuale?
- Si mund t'i mbështes që të zhvillojnë ato pika të forta?

## Përgatitni fëmijët

Pjesëmarrja kërkon që fëmijët të ndajnë idetë, mendimet dhe ndjenjat e tyre hapur dhe me ndershmëri. Është e nevojshme të krijojmë një mjedis ku ata të ndihen të mbrojtur dhe të sigurt për ta bërë këtë përpara se të hyjnë në veprim. Disa mënyra që t'ia arrijmë kësaj janë:

**Zhvilloni marrëdhënie pozitive**

Marrëdhëniet pozitive dhe plot besim mes fëmijëve dhe të rriturve janë të rëndësishme për të pasur pjesëmarrje të vërtetë. Ato nxitin komunikimin e hapur dhe partneritete mbështetëse.

Kaloni kohë për të zhvilluar marrëdhënie pozitive me fëmijët, duke filluar me lojëra dhe aktivitete zbavitëse, që lejojnë mundësi për ndërveprim të çlirët. Kjo krijon kujtime të përbashkëta që mund të ndihmojnë në forcimin e marrëdhënieve të ardhshme. Lejoni hapësirë për biseda të kuptimshme, që do t'u lejojnë fëmijëve dhe të rriturve të njohin njëri-tjetrin në një nivel më personal. Mundohuni të gjeni interesat dhe përvojat e përbashkëta që do të nxitin lidhjen me njëri-tjetrin.

## Ide për aktivitete që ndihmojnë në ndërtimin e marrëdhënieve

- Sporte skuadrash, si: futboll, volejboli, frisbi etj.
- Udhëtime të shkurtra në muze, vende turistike dhe vende të tjera zbavitëse.
- Lojëra grupi, si:

**SHPERNDARJA E POSTËS** – Grupi ulet në formë rrethi. Të gjitha karriget duhet të zihen dhe një person qëndron në këmbë në mes të rrethit. Personi në mes të rrethit thotë: “Unë po u dorëzoj postën të gjithë atyre që kanë...”. Pastaj ai përmend një karakteristikë, si për shembull: flokët e gjatë, syzet apo pantallonat blu. Kushdo që e ka atë karakteristikë duhet të ngrihet në këmbë dhe të vrapojë për te një karrige tjetër, ndërkohë që edhe personi në mes përpiqet të ulet në një karrige. Ai që mbetet pa karrige bëhet personi që do të shpërndajë postën, dhe loja fillon nga e para.

**REPORTERËT** – Në grupe dyshe, fëmijët i japin partnerit emrin dhe informacione të tjera rreth vetes, për shembull: çfarë kanë ngrënë për mëngjes, kafshën dhe ushqimin e tyre të preferuar e kështu me radhë. Pas dy a tre minutash, të gjithë kthehen në grup dhe i raportojnë grupit informacionet që kanë mësuar për partnerin. Kjo lojë mund të përdoret për të prezantuar njerëzit e rinj. Fëmijëve mund t'u jepet një pyetje që t'i përgjigjen gjatë diskutimit, me qëllim që të paraqitet një çështje që do të diskutohet më vonë në një sesion të veçantë.

**Përkrahni njohjen**

Fëmijët nuk mund të reagojnë në mënyrë të kuptimshme ndaj çështjeve sociale, nëse nuk u jepet më parë mundësia që të mësojnë rreth tyre dhe t'i kuptojnë ato. Padituria është pengesë për pjesëmarrje, ndërsa njohuria mund të çojë në pjesëmarrje të mirë. Kaloni kohë për t'i informuar fëmijët për çështjet që u prekin jetën duke organizuar seminare ose evenimente të tjera nxënieje. Lejoni fëmijët që të reflektojnë mbi informacionin e paraqitur dhe të reagojnë ndaj tij duke i shprehur pikëpamjet e tyre me njëri-tjetrin në grupe të vogla dhe, më vonë, me të rriturit. Edukimi moshatar (fëmijë me fëmijë) është një mënyrë e efektshme që fëmijët të marrin dhe të shkëmbejnë informacione dhe pikëpamje me njëri-tjetrin dhe t'u ngjallet interesi për çështjet sociale.

**Fitoni mirëkuptimin**

Në mënyrë ideale, axhendën duhet ta përcaktojnë fëmijët. Sidoqoftë, kur fillojmë inkurajimin e pjesëmarrjes së fëmijëve është thelbësore që të fitojmë mbështetjen dhe përkushtimin e tyre. Pa mirëkuptimin e tyre, fëmijët mund të ndihen sikur po manipulohen ose mashtrohen. Nëse fitojmë mirëkuptimin e tyre, fëmijët do të jenë më të përkushtuar që të marrin pjesë, sidomos në mënyrë afatgjatë. Informoni fëmijët për rolet e tyre para se të filloni aktivitetin. Pranoni faktin se disa fëmijë të cenusëm, me qëllim që të marrin pjesë, shpesh do të heqin dorë nga koha e tyre dhe nga mundësi që u sigurojnë të ardhura. Jini të vetëdijshëm për këtë dhe sigurohuni që pjesëmarrja e tyre të përputhet me aktivitetet e punës së tyre. Nëse është e mundur, pyetini si duan që të përfshihen dhe ndihmohini që të planifikojnë vetë rolet që duan të luajnë. Bëjuni të qartë se çfarë presin fëmijët dhe të rriturit nga ky projekt dhe nga njëri-tjetri dhe sigurohuni që ato pritshmëri të jenë realiste dhe të pranohen nga të gjithë.

## Reflektim

- Çfarë lojërash kemi përdorur me fëmijët, që na kanë ndihmuar të ndërtojmë marrëdhënie?
- A mund të mendojmë për ndonjë lojë që mund të fillojmë ta përdorim?
- Çfarë planifikimi mund të nevojitet?
- Çfarë aktivitetesh mund të kryejmë me fëmijët që do të lejojnë të ndodhin biseda?
- Çfarë mënyrash krijuese mund të mendojmë për të ndarë informacione me fëmijët?
- Si duhet të jenë ndryshe këto metoda nga ato që përdorim me të rriturit?

**Përgatitni komunitetin më të gjerë**

Kultura dhe tradita mund të përbëjnë pengesa për pjesëmarrjen e fëmijëve. Shpesh fëmijët sigurojnë përkujdesje për njëri-tjetrin, punë dhe të ardhura në shumë familje, por, megjithatë, e kanë të vështirë që të ndajnë pikëpamjet e tyre.

Shkollat dhe kishat mund t'u sigurojnë fëmijëve mundësi për të marrë pjesë në klube, në grupe të rinjsh dhe në aktivitete të tjera. Sidoqoftë, këto zakonisht modelohen për fëmijët dhe jo me ta.

Mënyra të efektshme për të rritur ndërgjegjësimin e komunitetit për vlerën e pjesëmarrjes së fëmijëve janë si më poshtë:

- Raportimi te drejtuesit e komunitetit i rezultateve të punës kërkimore të kryer nga fëmijët.
- Ftesa, nga drejtuesit e komunitetit, e prindërve, e mësuesve, e drejtuesve të kishave dhe e anëtarëve të tjerë të komunitetit në një hapje ose paraqitje zyrtare të kryer nga

**STUDIM  
MODEL**

Stephenson  
(1998a)

fëmijët për diçka që ata kanë arritur së bashku.

- Të rriturit dhe fëmijët kryejnë së bashku aktivitete nxënieje dhe veprimi pjesëmarrës (NVP).

Studimi model i mëposhtëm tregon se fëmijët kanë disa shqetësime që janë të ndryshme nga ato të të rriturve. Fëmijët u përqendruan te çështje specifike që u prekjin jetën e

Fëmijët dhe të rriturit në një fshat të Indisë së Jugut u mbledhën për të diskutuar për çështje me të cilat përballen fëmijët në komunitetin e tyre. Fshatarët u ndanë në tri grupe: burra, gra dhe fëmijë. Secilit grup iu kërkua që t'u përgjigjej tri pyetjeve dhe të hidhnin përgjigjet mbi një fletë të madhe letre. Komentet i shkruante një anëtar i grupit që dinte të shkruante dhe të lexonte.

Pyetjet ishin:

- Si kontribuojnë fëmijët në fshat?
- Çfarë problemesh kanë fëmijët?
- Pse i kanë këto probleme?

Përgjigjet nga grupet (burra, gra, fëmijë) u shkruan në një fletë të madhe letre. Rezultatet janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Pyetjet	Përgjigjet e burrave:	Përgjigjet e grave:	Përgjigjet e fëmijëve:
Si kontribuojnë fëmijët në fshat?	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Shramadan</i>*</li> <li>• Mbjellje pemësh</li> <li>• Bletari</li> <li>• Ndërtimi i qendrës komunitare</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Shramadan</i></li> <li>• Zbavitje</li> <li>• Mësojnë si të hedhin firmën</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Shramadan</i></li> <li>• Mbështetje për jetimët</li> <li>• Bletari</li> <li>• Aktivitete të përditshme të fëmijëve</li> <li>• Lutje për shi</li> </ul>
Çfarë problemesh kanë fëmijët?	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Varfëria</li> <li>• Analfabetizmi</li> <li>• Transporti jo i shpeshtë</li> <li>• Numri tepër i madh i fëmijëve</li> <li>• Shëndeti i lig</li> <li>• Pompa e prishur e ujit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Varfëria</li> <li>• Mungesa e materialeve shkollore</li> <li>• Transporti jo i shpeshtë</li> <li>• Numri tepër i madh i fëmijëve</li> <li>• Shëndeti i lig</li> <li>• Pompa e prishur e ujit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• E vështirë të shkosh deri te shkolla</li> <li>• Nuk ka kënd lojërash</li> <li>• Transporti jo i shpeshtë</li> <li>• Ndriçimi i dobët për shkak të tensionit të ulët – vështirë të studiohet natën</li> <li>• Shëndeti i lig</li> <li>• Transportimi i ujit</li> <li>• Nuk ka vend ku të takohemi</li> </ul>
Pse i kanë këto probleme?	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Punësimi i pjesshëm</li> <li>• Nuk ka planifikim familjar</li> <li>• Nuk ka “zë” që të flasë në emër të fshatit</li> <li>• Nuk ka reagim nga qeveria</li> <li>• Kushte të këqija higjienike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Punësimi i pjesshëm</li> <li>• Nuk ka planifikim familjar</li> <li>• Nuk ka “zë” që të flasë në emër të fshatit</li> <li>• Nuk ka reagim nga qeveria</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rruga nuk është e mirëmbajtur</li> <li>• Fshati nuk jep një copë tokë për ta bërë kënd lojërash</li> <li>• Nuk ka burime</li> </ul>

\* *Shramadan* do të thotë një aktivitet kolektiv fshati për të ndihmuar veten.

përditshme, si për shembull, në aftësinë e tyre për të studiuar dhe në mungesën e një vendtakimi. Ushtrimi sfidoi të rriturit. “Tani e dimë çfarë u nevojitet fëmijëve”, – komentoi një burrë në fund të sesionit. “Jemi më të ndërgjegjësuar për problemet e fëmijëve. Është mirë që t’i përfshijmë edhe ata, sepse kështu dimë më tepër.”

Reflektim

- Cilat tradita dhe pikëpamje kulturore mund të bëhen pengesë për pjesëmarrjen e fëmijëve në komunitetet tona?
- Në çfarë mënyrash mund të rrisim ndërgjegjësimin për nevojën e pjesëmarrjes së fëmijëve në komunitetet tona?

### Përgatitni organizatën tonë

Nëse duam që fëmijët të marrin pjesë më tepër në komunitetet ku punojmë dhe në projektet që zbatojmë, ndoshta mund të na duhet të bëjmë ndryshime brenda organizatës sonë, për t’u siguruar që strukturat dhe stafi ynë e mbështesin pjesëmarrjen e tyre.

**Mbrojtja e fëmijëve**

Organizata duhet të ketë në funksionim një politikë për mbrojtjen e fëmijëve, përpara se anëtarët e stafit të punojnë me fëmijët. Do të ishte ideale nëse të gjithë anëtarët e stafit, që kanë kontakt me fëmijët gjatë procesit të punës, do të merrnin trajnim për mbrojtjen e fëmijëve. Udhëzues për praktikë të mirë janë zhvilluar nga *Tearfund* dhe janë dhënë te shtojca.

**Trajnimi i stafit**

Përveç trajnimit për mbrojtjen e fëmijëve, anëtarët e stafit duhen trajnuar për mënyrën se si të komunikojnë dhe të punojnë në mënyrë pjesëmarrëse me fëmijët. Ky libër përmban shumë ide të cilat mund të ndahen me anëtarët e stafit në një mjedis seminari.

**Struktura vendim-marrëse dhe organizative**

Duke përfshirë fëmijët, ne do të sfidojmë mënyrën se si organizata merr vendimet dhe menaxhon punën. Vendosni se në çfarë forme pjesëmarrja e fëmijëve do të ndikojë në mënyrën se si organizata bën politika, bën punë mbrojtëse të fëmijëve, rekruton staf dhe shqyrton programe. Pjesëmarrja e fëmijëve në të gjitha këto çështje do të mundësojë që organizata të bëhet një institucion që punon me, dhe jo vetëm për, fëmijët.

Reflektim

- A kemi politikë për mbrojtjen e fëmijëve? Nëse jo, ku mund të marrim informacion dhe ndihmë për të shkruar një të tillë?
- Cilat çështje kyçe duhet të trajtojnë trajnimi për mbrojtjen e fëmijëve?
- A duhet të marrim parasysh sigurimin e trajnimit të stafit tonë për mënyrën si të punojmë me fëmijët? A njohim ndokënd që mund të na e sigurojë këtë trajnim? Cilat çështje kyçe duhet të trajtojnë trajnimi?
- Në çfarë shkalle marrin pjesë fëmijët në vendim-marrje në organizatën tonë? Si mund t’u sigurojmë mundësi që të marrin më tepër pjesë në punën e organizatës sonë? Çfarë pengesash mund të na duhet të thyejmë?

**Lista e kontrollit të përgatitjes****Përgatitni të rriturit**

- Pranoni dhe trajtoni qëndrimet negative kundrejt fëmijëve.
- Pranoni çdo fëmijë si individ.
- Pranoni pikat e forta dhe të dobëta të fëmijëve.

**Përgatitni fëmijët**

- Zhvilloni marrëdhënie pozitive me fëmijët.
- Nxitni njohjen duke i informuar fëmijët për çështjet sociale.
- Bini dakord me fëmijët për rolet dhe pritshmëritë që kanë për përfshirjen e tyre.

**Përgatitni komunitetin më të gjerë**

- Rritni ndërgjegjësimin për dobitë e pjesëmarrjes së fëmijëve.
- Jepuni mundësi fëmijëve të paraqesin idetë dhe aktivitetet e tyre në një shërbesë kishe ose në ndonjë tubim tjetër komunitar.

**Përgatitni organizatën tonë**

- Përgatitni politika dhe trajnime për mbrojtjen e fëmijëve.
- Trajtoni stafin për mënyrën si të komunikojnë me fëmijët.
- Mendoni se si pjesëmarrja e fëmijëve do të prekë mënyrën si funksionon organizata.

## Reflektim

- Cilat janë çështjet kyçe për të cilat duhet të ndërgjegjësohemi kur përgatitemi për pjesëmarrjen e fëmijëve?
- Pse është kaq e rëndësishme të përgatitemi me kujdes, që fëmijët të marrin pjesë në mënyrë të efektshme?

# Integrimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në jetën e komunitetit

Çelësi për një pjesëmarrje të qëndrueshme të fëmijëve është krijimi i strukturave që i fuqizojnë fëmijët brenda familjeve dhe komuniteteve të tyre. Tipat e strukturave do të varen nga konteksti ku jetojnë fëmijët dhe nga tipi i pjesëmarrjes së përdorur.

Këtu paraqiten një sërë opsionesh:

**Klubet e fëmijëve** janë një mënyrë për të mundësuar fëmijët dhe organizatën që punon me ta që të eksplorojnë përjasje të ndryshme për pjesëmarrje. Klubet e fëmijëve mundësojnë një vend të sigurt ku fëmijët të nxënë, të luajnë dhe të kryejnë aktivitete që janë në dobi të komuniteteve të tyre. Aktivitetet e klubit duhen orientuar nga interesat e fëmijëve. Klubet përshtaten mirë brenda një përjasjeje që synon zhvillimin e komunitetit.

**Lëvizjet dhe rrjetet e fëmijëve** u sigurojnë fëmijëve mundësinë që të organizojnë, të planifikojnë dhe të zbatojnë veprime për të përmbushur nevojat dhe preokupimet e tyre.

**Këshillat e fëmijëve** përpiqen të ndikojnë në vendimmarrje në nivelin e komunitetit.

**Parlamentet e fëmijëve** sigurojnë mundësi që zëri i fëmijëve të dëgjohet në nivel shtetëror ose kombëtar.

## KLUBET E FËMIJËVE

Klubet e fëmijëve janë bërë një mënyrë popullore për të inkurajuar pjesëmarrjen. Ato u sigurojnë fëmijëve një vend të sigurt ku të mund të shprehen. Shembuj për klube fëmijësh mund të gjenden: në Nepal, në Sri-Lanka, në Bangladesh, në Malavi, si dhe në shumë vende të tjera. Këto klube kanë qenë të suksesshme jo vetëm për fëmijët e varfër të fshatit dhe të qytetit, por edhe për ata që punojnë në rrugë. Klubet është e lehtë për t'u krijuar. Ato u japin mundësi fëmijëve që të eksperimentojnë me vendimmarrjen, planifikimin, veprimin e përbashkët, si dhe me udhëheqjen.

STUDIM  
MODEL

CHISOMO,  
Malavi. Klub  
fëmijësh, jo klub  
për fëmijët

Shembuj të  
tjerë

Në vitin 1998, Kisha e Ujit të Gjallë ngriti një klub fëmijësh, *Chisomo-n*. Në përgjithësi, fëmijët në Malavi kanë pak status apo ndikim mbi vendimet që prekin jetën e tyre. Deri në çastin kur u hap *Chisomo* nuk kishte asnjë politikë qeveritare që të trajtonte nevojat e fëmijëve të rrugës.

Fëmijët që jetonin dhe punonin në rrugët e Blantyre-s, përcaktuan identitetin e klubit. Që nga fillimi, identiteti i tij u bazua në ngritjen e marrëdhënieve me bazë besimin mes fëmijëve dhe familjeve të tyre, si dhe në punën me ta për të trajtuar problemet e tyre, të drejtuara nga fuqia dhe urtësia e Perëndisë. Fëmijët përcaktuan logon dhe ia vunë vetë emrin klubit duke thënë: “*Kjo ka qenë dita më e mirë e jetës sonë. Është vërtet hiri i Perëndisë.*” (*Chisomo* do të thotë *hiri*.)

Mbajtja e vazhdueshme e një pjesëmarrjeje të mirë është sfidë. Klubi synon që të mbajë një nivel pjesëmarrjeje ku stafi dhe fëmijët punojnë së bashku për të sjellë ndryshimin. Nganjëherë, kjo bëhet me nismën e të rriturve dhe, herë të tjera, me nismën e fëmijëve. Ekziston rreziku që niveli i bashkëpunimit të rrëshqasë në nivelin e një konsultimi të thjeshtë, ku stafi planifikon programet dhe pastaj konsultohet me fëmijët. Në këtë rast, *Chisomo* do të bëhej klub për fëmijët dhe jo klub nën zotërimin e fëmijëve. Fëmijët do të fillonin ta mendonin klubin sikur ekziston që të sigurojë gjëra për ta dhe varësia e tyre do të rritej.

## VLERAT E CHISOMO-S

- Fëmijët të vendosen të parët
- Pjesëmarrje
- Ndryshimi afatgjatë
- Drejtësi
- Marrëdhënie besimi
- Pranim dhe dashuri
- Nivel i shkëlqyer
- Përfshirja e Perëndisë

Beteja për të ruajtur një identitet të bazuar në pjesëmarrjen e vërtetë të fëmijëve nuk përfundon asnjëherë. Ajo mbështetet te kthimi i vazhdueshëm te vlerat themelore të klubit.

- Brigada e Fëmijëve në Bangladesh është një grup shumë aktiv fëmijësh që punojnë në rrugë, i cili organizohet dhe drejtohet nga vetë fëmijët. Ata i kanë zhvilluar përpunuar vetë materialet e mësimin të shkrim-këndimit për të ndihmuar fëmijët e tjerë si ata që të mësojnë të shkruajnë dhe të lexojnë. Po kështu, ata ndihmojnë fëmijët që janë arrestuar ose ngacmuar nga policia.
- Në Sri-Lankën Lindore të prekur nga lufta u zhvillua një klub fëmijësh në një komunitet të vogël të kapur keq mes lëvizjes së rezistencës të armatosur dhe forcave qeveritare. Klubi u zhvillua ngadalë, me qëllim që të tregohej kujdes ndaj kulturës lokale. Klubi ka bërë të mundur kthimin e shokëve në shkollë, zgjerimin e godinës së shkollës dhe përfshirjen e qeverisë në sigurimin e mundësive për arsimim.
- *Save the Children* në Norvegji po punon me më tepër se 400 klube fëmijësh të bazuar në komunitete në pjesë të ndryshme të Nepalit. Klubet janë përfshirë në ngritjen e çështjeve sociale që prekin jetën e fëmijëve, dhe në punë mbrojtëse për të sjellë ndryshime sociale përmes një përfaqëseje të tipit *fëmijë me fëmijë*. *Save the Children* në Norvegji po punon edhe me Klubin e Fëmijëve Hatemalo në punë mbrojtëse në nivel kombëtar. Ajo shtron çështje që bazohen në përvojat dhe pikëpamjet e klubeve të fëmijëve në nivelin e bazës. Grupi i medias së Klubit të Fëmijëve Hatemalo është i përfshirë në shtrimin e çështjeve që kanë të bëjnë me fëmijët për debate publike, përmes transmetimeve radiofonike në rajonet qendrore dhe të tjera në Nepal. Ai rrit edhe ndërgjegjësimin e përgjithshëm të publikut duke përdorur afishe dhe drama në rrugë.



## Reflektim

- Cilat klube fëmijësh njohim në vendin tonë?
- Renditni dobitë e klubeve të fëmijëve.
- Si mund të sigurohemi që klubet e fëmijëve të zotërohen nga fëmijët dhe jo thjesht të ekzistojnë për ata?

## LËVIZJET DHE RRJETET E FËMIJËVE

Lëvizjet dhe rrjetet e fëmijëve sigurojnë hapësirë për fëmijët nga klubet ose grupet e tjera të organizuara, që të mblidhen së bashku në nivel lokal, kombëtar ose ndërkombëtar. Lëvizja ose rrjeti shpesh ka një qëllim ose fokus tematik specifik. Për shembull, fëmijët në punë mund të duan të rrisin ndërgjegjësimin për të drejtat e tyre ose mund të duan të bëjnë një fushatë për paqen. Lëvizja ose rrjeti zakonisht kërkon lehtësim dhe bashkëpunim të ndërsjellë mes organizatave që punojnë me këta fëmijë.

STUDIM  
MODEL

Rrjeti i Fëmijëve  
(Red de Ninos)  
të Kolumbisë

Rrjeti i Fëmijëve të Kolumbisë ka bashkuar fëmijë të prekur nga konflikti dhe dhuna në atë vend. Fëmijë nga rajone të ndryshme përzgjedhin përfaqësues për të ngritur zërin për çështje specifike që i preokupojnë. Për shembull:

- shkrimi i një letre drejtuar kishave të Kolumbisë, ku u kërkua që të punojnë për çështje specifike që preokupojnë fëmijët;
- paraqitja e shqetësimeve të fëmijëve në sesionin e veçantë për fëmijët të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, veçanërisht para zyrtarëve nga Kolumbia;
- rritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e fëmijëve në komunitetet e tyre;
- fushatat për paqe dhe për lirim të atyre që janë/merren peng nga forcat paramilitare dhe guerile në nivel lokal.

STUDIM  
MODEL

Bhima Sangha.  
Sindikata e  
Fëmijëve në  
Punë

– Ramachandran  
dhe Saihjee (2001)

Organizata e të Preokupuarve për Fëmijët në Punë (*Concerned for Working Children, CWC*) në shtetin Karnataka, në Indinë e Jugut, ka punuar për shumë vite me fëmijët në punë. CWC ndihmoi në formimin e një sindikate të fëmijëve në punë, të quajtur *Bhima Sangha*, e cila u mundëson fëmijëve në punë të marrin pjesë në këshillat lokale të fshatrave dhe të rrisin ndërgjegjësimin për çështje me të cilat përballen fëmijët në punë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ajo ka tani një anëtarësi prej 25000 fëmijësh në punë.

Synimi i *Bhima Sangha-s* është t'u sigurojë fëmijëve në punë mundësi që të diskutojnë çështje të ndryshme me njëri-tjetrin dhe me ata që i rrethojnë, me qëllim që të fitojnë një identitet kolektiv dhe të dukshëm si punëtorë. *Bhima Sangha* ka luajtur një rol kyç në strategjinë e CWC-së për të arritur të fëmijët që punojnë duke folur me ta dhe duke u dhënë mundësinë të shprehin frikën, shqetësimet dhe ëndrrat e tyre. Ajo u ka siguruar fëmijëve mundësinë të flasin me njëri-tjetrin për situatat që i kanë detyruar të bëhen fëmijë që punojnë, pse kanë lënë shkollën, si dhe për shpresat e tyre në të ardhmen.

STUDIM  
MODEL

MANTHOC,  
Lëvizja e  
Fëmijëve  
në Punë e  
Punëtorëve të  
Krishterë, Peru

MANTHOC përbëhet prej rreth 2000 fëmijësh në punë nga mbi 130 komunitete në mbarë Perunë. Organizata ndahet në grupe prej 10 – 30 fëmijësh. Këto grupe punojnë me të rriturit, të cilët i ndihmojnë që të zhvillojnë plane dhe aktivitete që u plotësojnë nevojat specifike. Këtu përfshihet:

- Arsimimi – forma alternative shkolle për t'ua përshtatur orareve të tyre të punës.
- Trajnimi profesional dhe promovimi i zhvillimit të bizneseve të vogla.
- Fokusimi te edukata shëndetësore.
- Ngritja e mensave të komunitetit për të ndihmuar në përmirësimin e ushqyerjes së fëmijëve të varfër në komunitet.

Grupet dërgojnë përfaqësues në takimet që mbahen një herë në vit në nivel departamentesh ose në nivel kombëtar. Ky proces u bën të mundur fëmijëve që të paraqesin propozime për ndryshime politikash në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar prej të cilave do të përfitonin vetë ata.

## Reflektim

- Cilat lëvizje dhe rrjete fëmijësh ekzistojnë në vendin tonë?
- Cilat janë dobitë e lëvizjeve dhe rrjeteve të fëmijëve?
- Cilat janë pengesat ndaj lëvizjeve dhe rrjeteve të fëmijëve? Si mund të kapërcehen ato?

## KËSHILLAT E FËMIJËVE

Mundësimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal mund të jetë një sfidë e madhe. Krijimi i një hapësire formale për fëmijët në këshillat e fshatit ose komitetet e zhvillimit, mund të jenë një hap i rëndësishëm në mposhtjen e kësaj sfide.

STUDIM  
MODEL

Pançajatet  
makkala, Indi  
– CWC (2002)

Të Preokupuarit për Fëmijët në Punë (CWC) dhe *Bimha Sangha*, Sindikata e Fëmijëve në Punë, ndërmjetësuan me autoritetet lokale krijimin e përfaqësimit në nivel fshati të fëmijëve. Si rezultat, u zhvilluan *pançajatet makkala* (këshillat e fëmijëve), që kanë përfaqësimin e tyre në *pançajatet* e fshatit.

Anëtarët e *pançajateve makkala* kryejnë anketime shtëpi më shtëpi për të siguruar informacion të saktë për fëmijët në fshat. Ata përdorin instrumente të ndryshme kërkimore për të zbuluar çështjet dhe nevojat e fëmijëve në komunitetet e tyre. Ky informacion përdoret për të planifikuar strategji dhe për të bërë lobing për veprime specifike në *pançajatin* e fshatit të tyre. Kjo mund të ketë lidhje me arsimin, me fëmijët në punë, me shëndetin dhe me nevojat për infrastrukturë, si: ura këmbësorësh, shkolla dhe kopshte.

Për fëmijët e përfshirë në këtë gjë, pjesëmarrja nuk është thjesht një mundësi për të marrë pjesë në takime, për t'u konsultuar nganjëherë apo për të kënduar këngë në ndonjë ceremoni inaugurimi. Sipas tyre, pjesëmarrja i ndihmon ata që të bëhen mbrojtës të nevojave të tyre dhe për të transformuar situatat ku ndodhen. Pjesëmarrja nënkupton marrjen e një roli kryesor.

## Reflektim

- Çfarë mundësish kanë fëmijët që të kontribuojnë në komunitet me pikëpamjet e tyre?
- Cilat struktura vendimmarrëse ekzistojnë në komunitetet ku punojmë ne, ku fëmijët mund të inkurajohen që të marrin pjesë?
- Si mund të ndihmojmë fëmijët që të marrin pjesë në vendimmarrje në komunitet?

## PARLAMENTET E FËMIJËVE

Parlamentet e fëmijëve janë forume përfaqësuese kombëtare për fëmijë, ku ata diskutojnë për politika dhe çështje të mbrojtjes së të drejtave. Synimi i tyre është të krijojnë një zë për fëmijët në nivelin politik, në mënyrë që interesat e fëmijëve të promovohen në diskutimet për politika.

## STUDIM MODEL

### Parlamenti i Fëmijëve të Bangladeshit

*Save the Children* në Australi mbështeti fëmijët e Bangladeshit që të formonin një parlament fëmijësh, që u jepte fëmijëve hapësirën dhe mundësinë për të shprehur mendimet. Parlamenti i Fëmijëve është një forum kombëtar fëmijësh, i cili u lejon atyre t'u tregojnë preokupimet e tyre anëtarëve të Parlamentit të Bangladeshit. Synimi i Parlamentit të Fëmijëve është të ndikojë te politikëbërësit për të zhvilluar politika pro fëmijëve dhe për të marrë parasysh zhvillimin e fëmijëve të Bangladeshit.

Përpara se të vendosë për buxhetin kombëtar, ministri i Financave, shpesh, merr shumë studime, raporte dhe kërkesa nga grupe të veçanta interesi, por rrallëherë dëgohen shqetësimet e fëmijëve. Si rezultat, shpesh nuk pasqyrohen në buxhetin kombëtar nevojat dhe përparësitë e fëmijëve.

Në qershor të vitit 2003, gjatë sesionit për planifikimin e buxhetit në Parlamentin e Bangladeshit, Komiteti Përgatitor i Parlamentit të Fëmijëve organizoi një sesion diskutimi për buxhetin e fëmijëve. 68 fëmijë nga mbarë Bangladeshi morën pjesë në diskutimin e buxhetit, ku bënë thirrje për një pjesë të përshtatshme buxheti për mbijetesën, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre.


## Reflektim

- Cilat janë avantazhet e parlamenteve të fëmijëve?
- Cilat aktivitete do të nevojiteshin për të ngritur një parlament fëmijësh?

## 4

# Pjesëmarrja e fëmijëve në ciklin e projektit

Procesi i planifikimit dhe i menaxhimit të projekteve mund të vizatohet si cikël. Secila fazë e projektit çon te faza tjetër.



## Identifikimi i projektit

Nënkupton kryerjen e një vlerësimi nevojash për të identifikuar se mbi çfarë do të fokusohet projekti.

## Plani i projektit

Nënkupton kryerjen e një pune të mëtejshme kërkimore te njerëzit që preken nga problemi dhe mënyrën si preken prej tij (palët e interesit), duke identifikuar rrezikun e projektit dhe mënyrën si do të matet ekzekutimi i tij.

## Zbatimi dhe vlerësimi

Gjatë fazës zbatuese të projektit duhet monitoruar ecuria e tij, si dhe duhen kryer analiza në intervale të rregullta. Kur projekti të përfundojë, duhet bërë një analizë duke pasur si synim vlerësimin e ndikimit afatgjatë dhe qëndrueshmërisë së projektit.

## Nxënia e mësimëve

Mjetet planifikuese të përdorura gjatë fazës së planit të projektit duhen përsëritur gjatë gjithë kohës së projektit. Kjo bën të mundur që të shpjegohet çdo ndryshim që mund të prekë suksesin e tij. Rezultatet e monitorimit, e analizës dhe ushtrimet e vlerësimit duhen dokumentuar në dobi të nxënies organizative, në mënyrë që të përmirësohen projektet e tjera.

Fëmijët duhen përfshirë si palë interesi në ciklin e projektit, duke dhënë mendime, sugjerime, informacione dhe duke marrë pjesë në zbatimin dhe në vlerësimin përfundimtar të tij.

Fëmijët mund të inkurajohen që të marrin rolin drejtues në përcaktimin e nevojave të tyre, duke planifikuar projektin dhe duke mbledhur informacionin e nevojshëm. Më pas ata mund të mbështeten për të kryer dhe vlerësuar projektin.

Nënpjesët e mëposhtme përqendrohen te fazat e ndryshme të ciklit të projektit. Ato sugjerojnë disa mënyra se si pjesëmarrja e fëmijëve mund të ndërtohet brenda planifikimit dhe menaxhimit të projektit.

## 4.1. Identifikimi i projektit

“Hapi i parë në ciklin e projektit është të identifikohen nevojat që mund të trajtojë një projekt zhvillimi. Nganjëherë ky quhet **vlerësim nevojash**. Vlerësimi i nevojave mëson cilat janë nevojat e komunitetit dhe kë prekin ato. Vetëm kur dimë çfarë duan vërtet njerëzit, atëherë do të jemi në gjendje të zhvillojmë një projekt të efektshëm zhvillimi.”  
ROOTS 5: *Project cycle management*

Ndoshta tashmë e kemi një ide të mirë të nevojave lokale. Sidoqoftë, përvoja dhe puna e kaluar me projekte në komunitet nuk garantojnë njohje të plotë të nevojave të komunitetit. Shumë organizata nuk i përfshijnë fëmijët si palë interesi në vlerësimin e nevojave. Kjo ndodh se, ndoshta, mendojnë që:

- fëmijët nuk do të përfitojnë drejtpërdrejt nga projekti;
- fëmijëve u mungon përvoja, aftësitë dhe njohuritë e nevojshme.

Si rrjedhojë, fëmijët shpesh anashkalohehen si palë kyçe interesi edhe në projekte prej të cilave ata janë përfitues të drejtpërdrejtë. Një sfidë mjaft më e fortë është t'i përfshish ata në vlerësimin e nevojave të zhvillimit të komunitetit më të gjerë. Fëmijët zotërojnë njohuri të dobishme dhe të rëndësishme që nuk mund të sigurohen nga asnjë tjetër në komunitet.

Shumica e mjeteve të vlerësimit të nevojave mund t'i përshtaten përdorimit të fëmijëve. Disa ide për këtë janë skicuar më poshtë. Trajnimi në komunikimin me fëmijët, zhvillimin e fëmijëve, si dhe çështjet e moshës dhe të gjinisë janë thelbësore për përdorimin me sukses të këtyre teknikave.

### MJETET E VLERËSIMIT TË NEVOJAVE


Mjetet e mëposhtme janë aktivitete pjesëmarrëse që janë përshtatur për t'u përdorur me fëmijët.

#### Dëgjimi i fëmijëve

Të rriturit mund ta kenë të vështirë të dëgjojnë fëmijët, si dhe të dëgjojnë për përvojat e fëmijëve në situata të cënueshme. Është e rëndësishme që atyre t'u jepet shumë kohë që të përshkruajnë përvojën dhe pikëpamjet e veta.

### Pemët e ëndrrave

*Mosoj Yan* është një organizatë që punon me vajzat e rrugës dhe ato në punë në Koçabamba, Bolivi. Si pjesë e procesit të tyre për identifikimin e projektit, vajzat më të rritura ndihmojnë vajzat e tjera që të vizatojnë një “pemë ëndrrash”. Ato u thonë vajzave të identifikojnë se cilat rrënjë nevojiten që t’u japin mundësi dhe mbrojtje në jetën e tyre, si për shembull: drejtësia, dashuria dhe barazia. Më pas vajzat e mbushin trungun e pemës me probleme me të cilat përballen në atë moment, si: shfrytëzimi, izolimi, diskriminimi dhe mungesa e arsimit. Lulet ose frutat e pemës përfaqësojnë situatën ideale ku do t’u pëlqente ta shihnin veten. Për shembull, atyre mund t’u pëlqejë të kenë aftësi dhe rrjete sociale më të mira.



Peizazhi rreth pemës përfaqëson gjërat që mund të bëjnë të ndodhë kjo gjë. Ato u caktojnë një rend përparësie sugjerimeve dhe pastaj i prezantojnë para stafit të *Mosoj Yan*. Një nga këto sugjerime çoi në formimin e “qelizave” me vajza në punë, që u organizuan në pjesë të ndryshme të qytetit, për të edukuar vajzat e tjera në punë që s’mund të vijnë dot në qendrën edukative të *Mosoj Yan*.

### Teatri për zhvillim

Shumë fëmijëve u pëlqejnë dramat. Kjo mund të përdoret për të shqyrtuar çështje që janë të rëndësishme për ta. Duke përdorur teatrin për zhvillim:

- identifikoni çështjet e rëndësishme me një grup fëmijësh;
- përzgjidhni çështje mbi të cilat duan të përqendrohen fëmijët;
- zhvilloni një dramë në bazë të këtyre çështjeve;
- interpretoni dramën para një auditori;
- inkurajoni auditorin që të diskutojë për çështjet e parashtruara nga drama.

### Ecjet tërthorazi

Fëmijët mund t’u mësojnë të rriturve shumë gjëra rreth komunitetit të tyre duke i çuar në një shëtitje rreth tij. Fëmijët mund t’u tregojnë atyre se:

- çfarë është e rëndësishme për ta, dhe pse;
- nga çfarë kanë frikë, dhe pse;
- çfarë do të donin të ndryshonin;
- çfarë u pëlqen ose nuk u pëlqen në komunitet;
- ku jetojnë fëmijët e cenusëshëm, si ata me aftësi të kufizuara.

## Bërja e hartës

Fëmijët janë po aq të mirë sa edhe të rriturit që të bëjnë një hartë të jetës dhe të komunitetit të tyre. Ky është një aktivitet që atyre, shpesh, u duket shumë më zbavitës sesa metodat e tjera për vlerësimin e nevojave, si për shembull intervistat. Hartat mund të vizatohen përtokë duke përdorur shkopinjë, gurë dhe materiale të tjera të disponueshme pa problem në atë vend; mund të përdoren edhe letra e lapsa. Fëmijëve nuk duhet t'u jepet shumë drejtim për atë që do të vizatojnë. Bëjuni vetëm një pyetje në lidhje me një çështje të caktuar dhe lërini të vizatojnë një hartë krijuese që i përgjigjet pyetjes. Hartat mund të vizatohen për të përfaqësuar një sërë gjërash. Për shembull:

- **LËVIZJA:** Ku shkojnë përditë fëmijët?
- **MIGRIMI:** (Sidomos për fëmijët që jetojnë e punojnë në rrugë.) Nga vijnë ata?
- **KOMUNITETI:** Cilat janë aspektet pozitive dhe negative të komunitetit?


## Renditja

Renditja përdoret për të treguar përparësitë. Ajo mund të përdoret pas një sërë ushtrimesh pjesëmarrëse. Për shembull, mund të përdoret pasi fëmijët kanë hedhur në hartë aspektet pozitive dhe negative të komunitetit të tyre:

- Shkruani ose vizatoni përtokë aspektet pozitive.
- Jepini secilit fëmijë nga dhjetë fasule ose numërues me gurë. Ata mund të vendosin sa numërues të duan përbri çdo aspekti, sipas rëndësisë që mendojnë se kanë. Sa më tepër numërues të ketë aspekti i caktuar, aq më i rëndësishëm është ai për ta. Ata edhe mund t'i vendosin të gjithë gurët numërues përbri një aspekti të vetëm, nëse mendojnë se të tjerët s'janë të rëndësishëm për ta.
- Përsëriteni ushtrimin me aspektet negative.
- Nxitni diskutimin për këto rezultate, sidomos aspektet më negative të komunitetit.

## Intervistat “fëmijë me fëmijë”

Intervistat “fëmijë me fëmijë” i ndihmojnë ata që të mbledhin informacion-bazë. Fëmijët edhe mund të përfshihen në analizimin e këtyre të dhënave-bazë. Së pari, është e rëndësishme që fëmijët të trajnohen në teknikat intervistuese.



Hartë e vizatuar nga një djalë në Kampala për vende që kanë rëndësi për të.

Marrë nga Young dhe Barrett (2001)

**STUDIM  
MODEL**

Bhima Sangha

Sindikata e Fëmijëve në Punë *Bhima Sangha* donte të dokumentonte përvojën e *pançajateve makkala*. Ata intervistuan anëtarë të *pançajateve makkala*.

Teknika që u përdor për të hapur diskutimin ishte “topi i zjarrtë”. Ata i kaluan njëri-tjetrit në formë rrethi një arrë kokosi. Dikush u zgjodh që të mbyllte sytë dhe të duartrokiste në një moment të pacaktuar. Sapo të dëgjonin duartrokitjen, kushdo që do të kishte arrën e kokosit duhej t’i përgjigjej një pyetjeje.

Fëmijët i regjistruan intervistat me magnetofon dhe, më vonë, i shkruan ato që u thanë. Më pas ato u analizuan. Rezultatet iu dhanë Sindikatës për ta ndihmuar që të planifikonte punën e ardhshme me *pançajatet* e fshatrave.

**Grafiku i aktiviteteve të përditshme**


U thoni fëmijëve që të bëjnë dokumentimin e jetës së tyre të përditshme në një grafik. Ai duhet të përfshijë vizatime, por fëmijët më të rritur mund të shkruajnë edhe shënime të shkurtra. Grafikët mund të analizohen për të parë se sa kohë kalojnë fëmijët në punë, në shkollë dhe në lojë. Në zonat rurale, mund të jetë interesante t’u kërkosh fëmijëve të vizatojnë grafikë për stinët e ndryshme të vitit, për të parë si qëndrojnë në krahasim me njëri-tjetrin.

- Çfarë bëjnë në një ditë të zakonshme?
- Sa orë kalojnë për çdo detyrë?

**SHEMBULL**

i një grafiku të përditshëm aktiviteteve nga një fëmijë me aftësi të kufizuara

Mclvor (2001)





## Këngët

Në disa kultura, këngët e kënduara nga fëmijët mund të tregojnë shqetësimet dhe përparësitë e tyre. Për shembull, fëmijët mund të përdorin këngë Rep për të shprehur pikëpamjet. Deizi, një vajzë 17-vjeçare e shpërngulur nga konflikti në Kolumbi, komponon këngë Rep për luftën, abuzimin dhe shpresat për paqe.

### Repi i Dejzit:

*“Ditën e mirë, natën e mirë, mirëdita, mirëmbërëma.*

*Është ditë me shumë shi dhe ne po shkojmë në fusha, po këndojmë dhe flasim për atë që do të ndodhë.*

*Menduam për të ardhmen dhe gjërat e këqija që kemi të përbashkëta.*

*Forcë dhe tolerancë pavarësisht nga distanca.*

*Nuk duam më luftë. Paqe në qytet dhe fusha.*

*Po i kapim përdore fëmijët që po qajnë.*

*Shohim gratë dhe burrat që bërtasin, ekziston një botë më e shëndetshme ku të jetojmë.*

*Vëllezër dhe motra, na duhet ndihma juaj, sepse fëmijët po vdesin nëpër rrugë.”*

## Grupet e fokusit

Fëmijët mund të jenë më të gatshëm të flasin në grupe, sesa në intervista individuale me një të rritur. Grupet e fokusit, nëse lehtësohen mirë, mund të sigurojnë informacion të shkëlqyer.

Përshtatur nga  
Grupi Rajonal i  
Punës për Punën e  
Fëmijëve (2002).

Grupet e fokusit nënkuptojnë diskutimin për një temë të veçantë, që drejtohet nga një lehtësues. Ato janë të dobishme për eksplorimin e ideve dhe të qëndrimeve mbi të cilat është rënë dakord dhe sidomos për punën e hershme kërkimore, me qëllim që të kuptohet cilat pyetje të bëhen dhe cilat fjalë të përdoren në intervista dhe pyetësorë. Diskutimi në grupet e fokusit kërkon:

- 8 deri në 15 pjesëmarrës me karakteristika të përbashkëta, si për shembull një grup fëmijësh që punojnë në rrugë.
- Një vend të rehatshëm pa ndërprerje ose spektatorë.
- Hapësirë të mjaftueshme pa tryeza ose banka që të bllokojnë hapësirën mes tyre, ku gjithsecili të ulet rehat në formë rrethi.
- Një kohë të caktuar për diskutim (jo më pak se një orë dhe, normalisht, jo më tepër se dy orë).
- Listën e ideve, të pyetjeve ose të temave që do të trajtohen.
- Një lehtësues të aftë.
- Të paktën një person të aftë që të mbajë shënime.

Kujdes!

- Disa individë mund të mbizotërojnë në grupet e fokusit.
- Njerëzit që s'ndihen rehat të flasin në publik mund të përjashtohen.

## Konsultimet

Konsultimet janë mënyrë e efektshme për të krijuar ide dhe përkim mes fëmijëve. Ato ndryshojnë nga grupet e fokusit, të cilat përdoren për të përfutur informacion. Konsultimet mund të sjellin së bashku grupe fëmijësh me shqetësime të ngjashme për të trajtuar çështje që i prekin. Po kështu, ato mund të tolerojnë një mjedis ku vendimmarrësit e rritur mund të dëgjojnë fëmijët. Për shembull, fëmijët e shpërngulur nga konflikti dhe dhuna në Kolumbi u mblodhën së bashku për të diskutuar mbi disa rekomandime për përfaqësuesit e vendeve që morën pjesë në sesionin e veçantë për fëmijët të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

## STUDIM MODEL

Lëvizja  
Kombëtare e  
Fëmijëve në  
Punë në Indi  
– për fëmijët,  
nga fëmijët

Çdo vendi që ka firmosur konventën e Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e fëmijëve” (UNCRC) i kërkohet të paraqesë një raport në çdo pesë vjet për hapat e ndërmarrë nga qeveria për të vënë në zbatim konventën. Po kështu, Komiteti i UNCRC-së u kërkon OJQ-ve dhe organizatave të tjera të shoqërisë civile që të raportojnë për zbatimin e konventës nga ana e qeverisë. Më pas, Komiteti kërkon përgjigje nga qeveria në lidhje me çështjet e ngritura nga ato organizata.

Lëvizja Kombëtare e Fëmijëve në Punë (*National Movement of Working Children, NMWC*) – një aleancë kombëtare e organizatave të fëmijëve në punë në Indi – ishte pjesë e delegacionit indian të OJQ-ve dhe organizatave të shoqërisë civile të ftuara të paraqitnin raportet e tyre në zyrën e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë. Fëmijët e NMWC ishin të vetmit pjesëmarrës fëmijë në delegacion.

Raporti i tyre u përgatit plotësisht nga fëmijët dhe përmbante:

- Informacion për mënyrën si po respektoheshin të drejtat e tyre në lidhje me mbrojtjen e tyre, me sigurimin e shërbimeve dhe të infrastrukturës, si dhe të drejtën për pjesëmarrje.
- Detaje për nismat e tyre, që kanë ndihmuar në përmirësimin e jetës dhe në përmbushjen e të drejtave të tyre.
- Analizën e tyre për raportin e qeverisë së Indisë.
- Sugjerimet e tyre të ardhshme për veprim për të bërë të mundur përmbushjen e të drejtave të tyre.

## Lista e kontrollit të konsultimit

- Lini kohë për zhvillimin dhe testimin e materialeve që do të përdoren për konsultim.
- Mbani ushtrime të thjeshta e të qarta me një larmi aktivitete.
- Mblidhni komente nga grupet e synuara dhe lehtësuesit para se të përfundoni materialet.
- Flisni, nëse është e mundur, me njerëzit që punojnë me fëmijët për të marrë disa ide për llojet e aktiviteteve që do të kenë sukses.
- Hartoni një paketë konsultimi për lehtësuesit, e cila të përfshijë udhëzime, ide për thyerje akulli, si dhe këshilla për mënyrën si të përshtaten këto ushtrime. Mund të përfshihet edhe informacion reference, si për shembull një kopje e UNCRC-së dhe detaje kontakti për organizata të tjera të dobishme.
- Organizoni një takim për t’u dhënë informacion të gjithë lehtësuesve dhe shprehni qartë qëllimin e konsultimit.
- Diskutoni materialet me lehtësuesit. Jini të hapur ndaj ideve dhe sugjerimeve të reja.

## Përgatitja e materialeve

### Planifikimi i konsultimit

- Mbani mend se nivelet e përqendrimit dhe interesi i fëmijëve do të ndryshojnë sipas vetë fëmijëve, dinamikës së grupit dhe mjedisit ku ndodh konsultimi. Gjatësia dhe struktura e sesionit dhe e materialeve të përdorura duhet ta marrin parasysh këtë. Lehtësuesit duhet të monitorojnë nivelin e energjisë dhe të ndryshojnë aktivitetin për të ngritur këtë nivel, nëse është e nevojshme.
- Sigurohuni që të përfaqësohen edhe fëmijë nga grupet e cenueshme. Mos harroni se mund të jetë e vështirë që të arrihen këta fëmijë. Lini kohë të mjaftueshme për planifikimin dhe ngritjen e një rrjeti me kontakte dhe grupe të tjera, në rast se ndonjë grup vendos papritmas të mos marrë pjesë në konsultim.
- Sigurohuni që të gjithë lehtësuesit të ndjekin praktikën e mirë të mbrojtjes së fëmijëve.
- Sigurohuni që i rrituri në përgjegjësi të grupit të jetë gjithmonë i pranishëm. Asnjëherë mos kryeni intervista individuale me një fëmijë, nëse nuk është i pranishëm edhe një i rritur tjetër.
- Jini realistë për madhësinë e grupit. Një numër i përshtatshëm pjesëmarrësish do të ishte diku midis gjashtë deri në dhjetë veta. Nëse konsultimi kërkon informacion për çështje shumë të ndjeshme, atëherë do të ishin më të përshtatshme grupe më të vogla.
- Përpiquni, nëse është e mundur, të caktoni disa intervista individuale, në mënyrë që fëmijët të jenë në gjendje të flasin për çështje personale që, ndoshta, nuk duan t'i diskutojnë përpara fëmijëve të tjerë.

### Kryerja e sesioneve të konsultimit

- Përpiquni ta filloni sesionin me një aktivitet zbavitës për t'u nxitur fëmijëve interesin për konsultimin.
- Kaloni një kohë të shkurtër për të prezantuar njëri-tjetrin dhe përpiquni të mësoni emrat e të pranishmëve ose përdorni etiketat.
- Sigurohuni që të gjithë ta dinë qëllimin e konsultimit. Shpjegoni se çfarë do të ndodhë me informacionin që do të mblidhet, çfarë reagimi do të marrin ata dhe çfarë na kërkon ligji që të bëjmë, nëse një fëmijë na jep informacione për diçka të paligjshme. Thuaju fëmijëve se çdo informacion personal që japin nuk do t'u kalohet të tjerëve, përveçse nëse bëhet fjalë për diçka të paligjshme.
- Arrini në një marrëveshje me grupin se çdo individ duhet të tregojë respekt ndaj të tjerëve. Cilitdo që shkakton fyerje do t'i kërkohet të kërkojë falje ose të largohet nga konsultimi.
- Sigurohuni që konsultimi të mos kryhet tepër shpejt ose tepër ngadalë, sepse, përndryshe, fëmijëve do t'u humbasë interesi.
- Fëmijët nuk e kanë të lehtë të qëndrojnë pa lëvizur për një kohë të gjatë. Aktivitetet duhet të përfshijnë njëfarë variacioni në mënyrën e paraqitjes për t'u mbajtur të gjallë interesin.
- • Në fund të sesionit, falënderoni fëmijët për kontributin e tyre dhe kujtojeni mënyrën si do të marrin mendimin tuaj.

## Regjistrimi i të dhënave

- Nëse është e mundur, njëri nga lehtësuesit duhet të mbajë shënime gjatë gjithë kohës së konsultimit. Sigurohuni që citimet të shënohen me detaje të tilla, si: gjinia, moshë dhe grupi etnik i fëmijës.
- Çdo informacion i dhënë gjatë konsultimit duhet të përdoret me përgjegjshmëri.

## STUDIM MODEL

### Fëmijët e Kabulit

Në vitin 2001, *Save the Children* në SHBA (SC/US) nisi një projekt të madh kërkimor të quajtur “Fëmijët e Kabulit” për të analizuar punën e vet me fëmijët në Afganistan. Projekti kërkimor synonte të nxiste konsultimin e gjerë dhe të hapur me fëmijët, ku fëmijët dhe kujdestarët e tyre do të flisnin për jetën e tyre dhe do të identifikonin çështjet që i shqetësonin. SC/US planifikonte ta përdorte këtë informacion për të ndihmuar në zhvillimin e programeve të reja me fëmijët në Kabul. Ushtrimi ishte një anketim të dhënash bazë për fillimin e një cikli të ri programesh për çështjet e identifikuara nga fëmijët. Po kështu, ai ishte edhe fillimi i pjesëmarrjes më të madhe të fëmijëve në programet SC/US në përgjithësi.

Konsultimi zgjati gjashtë muaj. Më tepër se 400 fëmijë, të moshave 7 deri në 18 vjeç, u përfshinë në këtë projekt, bashkë me më tepër se 200 kujdestarë. Grupet e fokusit përbëheshin nga rreth 12 fëmijë, dhe u takuan për gjashtë diskutime gjithsej. Grupet diskutuan për çështje të tilla, si: marrëdhëniet në familje, rreziqet dhe vështirësitë me të cilat përballeshin fëmijët, puna dhe përgjegjësitë e fëmijëve, si dhe përjetimet dhe ndjenjat e fëmijëve. Pikat kryesore që u mësuan ishin:

- Nevoja për të siguruar mbështetje dhe trajnim intensiv për lehtësuesit e rritur. Aftësimi i fëmijëve që të shprehin pikëpamjet dhe opinionet e veta nuk u vjen medoemos natyrshëm të rriturve. Të rriturit mund t'i interpretojnë fjalët e fëmijëve si t'u vijnë për shtat.
- Dobia e instrumenteve të pjesëmarrjes. Të gjitha grupet e fokusit përdorën aktivitete kërkimore për pjesëmarrjen, si: vizatimin, aktrimin dhe tregimin e ndodhive. Këto aktivitete i nxitën fëmijët që të hapeshin dhe të shprehnin ide dhe shqetësime komplekse.
- Në komunitete ku SC/US po punon tashmë, grupet e fokusit bënë të mundur të ndërtohej besimi dhe lejuan informacion reagues mbi punën e tyre ekzistuese dhe të vazhdueshme.

Përmes analizës së bisedave, SC/US ia doli që të identifikonte disa zona kyçe për aktivitete të reja programesh. Për shembull, fëmijët në Kabul ishin të shqetësuar për sigurinë rrugore dhe lëndimin nga aksidentet e trafikut. Mbi bazën e këtij informacioni, SC/US ngriti fonde për zhvillimin e materialeve të sigurisë rrugore, që fokusohen te fëmijët.

Po kështu, SC/US punoi me fëmijët për të identifikuar çështjet lokale që i shqetësonin. Për shembull, në një komunitet, fëmijët ishin të shqetësuar për rrezikun e puseve të hapura; në një komunitet tjetër ishin të shqetësuar për qentë e tërbuar; në një komunitet tjetër ishin të shqetësuar për një vend plehrash. SC/US punoi me këto grupe fëmijësh për të mobilizuar komunitetin të vepronte për t'i zgjidhur këto probleme.

Pasi fëmijët i renditën sipas rëndësisë çështjet për të cilat donin të punonin dhe pasi identifikuan shkaqet thelbësore, vendosën për një plan veprimi në lidhje me trajtimin e problemit. Më pas, në takimet lokale të komunitetit, ata përfshinë prindërit dhe komunitetet lokale për të rritur ndërgjegjësimin për këtë problem. Ata hynë në veprim, ndonjëherë me mbështetjen financiare të SC/US dhe, herë të tjera, duke përdorur burimet e veta. Në fund vlerësuan suksesin e tyre në zgjidhjen e problemit.

Secila fazë e projektit përfshinte aktivitete pjesëmarrëse për të lehtësuar procesin dhe të menduarit e fëmijëve. Përmes këtyre fazave, SC/US ia doli të zhvendosej nga niveli i konsultimit me fëmijët, i përdorur në punën kërkimore, te niveli i mbështetjes së fëmijëve për të luajtur një rol kryesor në zgjidhjen e problemeve të komunitetit të tyre.

Përdorimi i  
NVP me fëmijët  
me aftësi të  
kufizuara

– përshtatur nga  
Jani (2001)

Disa instrumente të nxënies dhe veprimit pjesëmarrës (NPV) mund të kenë nevojë të përshtaten më tej për përdorim me fëmijët me aftësi të kufizuara. Idetë e mëposhtme vijnë nga përvoja me të verbër në Jemen.

- Shpjego procesin dhe aktivitetet para se të kryhen.
- Gjatë aktiviteteve, njerëzit që shohin shpjegojnë se çfarë po ndodh, në mënyrë që të verbrit të përfshihen në diskutime dhe prezantime.
- Gjatë aktiviteteve dhe diskutimeve, gjithsecili u drejtohet të tjerëve me emër, shpjegon në detaje çfarë po bëjnë ata dhe përdor fjalët e folura në vend që t'i tregojë gjërat me gisht.
- Në fund të secilit aktivitet kaloni kohë në reflektim për mënyrën si mund të përshtaten më mirë instrumentet herës tjetër.
- Për aktivitetet që përfshijnë trajnimin, mund të përdoren materiale që mund të preken në vend të stilolapsave, si për shembull: kokrriza, bar dhe kapëse letre.

Reflektim

- Në çfarë mënyrash i ka përfshirë organizata jonë fëmijët për t'u identifikuar nevojat?
- Cilat janë mundësitë dhe pengesat në rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në identifikimin e projektit?
- Çfarë aktivitetesh po përdorim tani për vlerësimin e nevojave? Si mund të përshtaten këto aktivitete për përdorim me fëmijët?
- Cilat ide të dhëna në këtë pjesë do të provojmë?
- Si mund të përshtaten instrumentet e kësaj pjese për përdorim me fëmijët me aftësi të kufizuara? Mund të jetë e nevojshme që ato të përshtaten në mënyra të ndryshme për fëmijët që nuk mund të dëgjojnë, të shohin, të lëvizin e kështu me radhë.

## 4.2. Plani i projektit

“Pasi nevoja parësore komunitare identifikohet, mund të fillojmë të mendojmë për mënyrën si ta trajtojmë.” ROOTS 5: *Project cycle management*

Gjatë fazës së hartimit të projektit, është e nevojshme të mbledhim informacion të mëtijshëm për problemin e identifikuar nga/për fëmijët, si dhe për kontekstin e tij.

### ANALIZA E PALËS SË INTERESIT

Projektet, sidomos ato që merren posaçërisht me fëmijët, duhet t'i përfshijnë gjithmonë fëmijët si palë parësore interesi. Fëmijët, ashtu si të rriturit, nuk janë të gjithë njësoj. Brenda çdo komuniteti, disa fëmijë do të jenë më pak të dukshëm për shkak të aftësive të kufizuara, të gjinisë, të etnisë, të kastës ose për shkak se janë të përfshirë në aktivitete që u sjellin të ardhura. Është e rëndësishme të siguroheni që zëri i tyre të dëgjohet.

Nëse projekti po trajton një problem që ka lidhje posaçërisht me fëmijët, ndoshta është mirë të përzgjedhim grupe të veçanta fëmijësh për pjesëmarrje. Për shembull, fokusi mund të jetë puna e fëmijëve ose fëmijët e përfshirë në trafikim. Palët e interesit mund

Përshtatur nga  
RWG-CL (2002)

të përfshijnë fëmijë punëtorë, fëmijë të trafikuar, prindërit e tyre, si dhe përfaqësues nga qeveria, nga organizata joqeveritare dhe nga organizata ndërkombëtare.


### PUNA KËRKIMORE ME FËMIJËT

Puna kërkimore është pjesë e rëndësishme e hartimit të duhur të projekteve. Projekti duhet të bazohet në informacion të besueshëm e të saktë. Pjesëmarrja e fëmijëve në punën kërkimore është e rëndësishme, sepse:

- rrit ndjesinë e pronësisë së projektit te fëmijët, duke u mundësuar të bëjnë kërkime për çështje që janë të rëndësishme për ta;
- pohon të drejtën e tyre për t'u shprehur, për t'u dëgjuar dhe për t'u marrë mendimin;
- u zhvillon aftësitë për të analizuar informacione;
- u jep siguri në vetvete dhe pavarësi;
- u zhvillon aftësinë për t'u mbrojtur prej gjërave të tilla si abuzimi;
- ndryshon mënyrën si të rriturit shohin fëmijët;
- ndryshon marrëdhënien mes të rriturve dhe fëmijëve;
- përmirëson cilësinë e rezultateve kërkimore, sepse fëmijët që bëjnë kërkimin mund të kenë akses të disa informacioneve që s'mund t'i kenë kërkuesit e rritur;
- ndihmon në zhvillimin e politikave dhe programeve më të mira për fëmijët.

Fazat e procesit  
kërkimor

Përshtatur nga  
RWG-CL (2002)



Kërkimi përbëhet nga një sërë fazash. Është e nevojshme të përcaktoni se në cilat faza do të përfshihen fëmijët në procesin kërkimor, dhe në ç'mënyrë. Këtu duhet të merret parasysh:

- koha e disponueshme si për organizatën e zhvillimit, ashtu edhe për fëmijët;
- mosha dhe kapacitetet e fëmijëve;
- natyra e punës kërkimore;
- përvoja e pjesëmarrjes së fëmijëve në të shkuarën. Fëmijët që marrin pjesë rregullisht në aktivitete që ua forcojnë aftësitë e tyre pjesëmarrëse, do të jenë në gjendje të marrin pjesë më tepër në secilën fazë.

Atje ku është e mundur, këto vendime duhen diskutuar me fëmijët dhe, nëse është e nevojshme, ato mund të ndryshohen gjatë procesit kërkimor. Ndoshta është mirë të vizatoni dhe plotësoni tabelën e mëposhtme.

### Pjesëmarrja e fëmijëve në hartimin e projektit

Përshtatur nga Kirby (1999)

FAZAT E PROCESIT PLANIFIKUES	NIVELI I PËRFSHIRJES <sup>1</sup>	KUSH DO TË KRYEJË DETYRAT?
Identifikoni palët e interesit dhe skuadrën kërkimore.		
Caktoni temën dhe synimet kërkimore.		
Mblidhni, shqyrtoni dhe analizoni informacionet dytësore.		
Zhvilloni pyetje kërkimore.		
Zgjidhni dhe zhvilloni instrumentet kërkimore.		
Testoni instrumentet kërkimore dhe finalizoni planin kërkimor.		
Mblidhni informacion: nga fëmijët, nga të rriturit dhe nga komuniteti.		
Analizoni të dhënat kërkimore.		
Shkruani raportin dhe rekomandimet.		
Shpërndani përfundimet, planin.		

<sup>1</sup> Në kolonën Niveli i përfshirjes shkruani: *s'ka, informim, konsultim, bashkëpunim ose rol kryesor*. Te kolona Kush do të kryejë detyrat? shkruani: *fëmijët, stafi i programit ose konsulenti i jashtëm*.

### Zgjedhja e skuadrës kërkimore

Fëmijët që marrin pjesë në skuadrën kërkimore duhen zgjedhur me kujdes duke marrë parasysh: moshën, gjininë dhe përvojën e tyre. Atje ku është e mundur, fëmijët duhen përfshirë në përzgjedhjen e anëtarëve të skuadrës kërkimore.

- Nëse punojmë me një klub fëmijësh ose grup adoleshentësh, e kemi tashmë një grup me hulumtues të mundshëm. Vendimi për të përzgjedhur fëmijët nga ky grup duhet marrë bashkë me fëmijët.
- Për çështje të mëdha kërkimore, gama e zgjedhjes së fëmijëve mund të jetë e gjerë. Për

shembull, nëse është identifikuar çështja e “mundësisë për të pasur ujë”, hulumtuesit mund të jenë *fëmijët lokalë*. Me qëllim që të kuptojmë gamën e çështjeve që kanë lidhje me mundësinë për të pasur ujë, duhet të përpiqemi të përfshijmë në hulumtim edhe djem, edhe vajza të moshave të ndryshme.

- Për pyetje më specifike kërkimore, duhen përzgjedhur fëmijët që përfaqësojnë popullsinë tek e cila po kryhet hulumtimi. Për shembull, nëse hulumtimi shqyrton mundësinë për të pasur ujë, gjë që ndikon në mosfrekuentimin e shkollës nga vajzat, shumica e hulumtuesve duhet të jenë vajza të moshës shkollore.

Mbështetja dhe përfshirja e të rriturve është kyçe. Duhet marrë parasysh trajnimi, përvoja, udhëzimi, mbështetja dhe çështjet e mbrojtjes dhe të ligjshmërisë.

### Përcaktimi i objektivave për punën kërkimore

Nganjëherë objektivat kërkimore janë vendosur tashmë nga stafi i projektit. Gjithsesi, fëmijët mund të përfshihen në përcaktimin e objektivave në mënyrat e mëposhtme:

**MARRJA E NJË ROLI KRYESOR** – Fëmijët vendosin se për çfarë çështjesh duan të bëjnë kërkime dhe pastaj shkruajnë objektivat e tyre.

**KONSULTIMI** – Stafi vendos për temën kërkimore, pastaj shkruan objektivat në konsultim me fëmijët.

**INFORMIMI** – Stafi vendos për temën, shkruan objektivat dhe u kërkon fëmijëve që t’i rishqyrtojnë.

### Mbledhja e informacionit

**Informacioni dytësor** është informacioni që kanë mbledhur njerëzit e tjerë. Për shembull, ne mund të shqyrtojmë libra të përqendruar te fëmijët, raporte kërkimore, video dhe dokumente statistikore, politikash ose ligjore. Anëtarëve të stafit, konsulentëve ose fëmijëve më të rritur mund t’u jepet përgjegjësia për mbledhjen e informacionit dytësor. Informacioni i mbledhur dhe analiza e tij duhet të ndahet me fëmijët gjatë kohës kur ata po zhvillojnë pyetjet kërkimore.

**Informacioni parësor** është informacioni që mbledhim vetë.

Kur mendojmë se cilët fëmijë të përfshihen në mbledhjen e informacionit parësor, duhet marrë parasysh çështjet e mëposhtme:

- nivelet e arsimit,
- aftësia e fëmijëve për t’u shprehur gojarisht,
- aksesit që kanë fëmijët me aftësi të kufizuara.

Përjashtet pjesëmarrëse, si vizatimi dhe hartimi, janë mënyra të përshtatshme për mbledhjen e informacionit nga fëmijët. Një opsion tjetër përbëjnë intervistat tradicionale dhe pyetësorët, ndonëse, pikësëpari, duhet vlerësuar aftësia e fëmijëve për t’i përdorur këto metoda. Disa nga metodat e përshkruara në faqet 30-35 janë të përshtatshme për fazën kërkimore. Metodatat në faqet e mëposhtme mund të përdoren me fëmijët.



## Anketimet dhe pyetësorët

Anketimet dhe pyetësorët janë të dobishëm kur përpiqemi të përftojmë një ide për modelet e sjelljes, të njohurive dhe të qëndrimeve të fëmijëve. Nëse po hulumtohen çështje të ndjeshme, mund të përdoret një pyetësor i shkruar për t'u bërë të mundur fëmijëve që të sigurojnë informacion pa u identifikuar. Sidoqoftë, pyetësorët e shkruar mund të plotësohen vetëm nga fëmijët që dinë të shkruajnë e të lexojnë. Pyetësorët e folur mund të përdoren me fëmijët me pak ose me aspak aftësi shkrimi e këndimi. Për ta bërë pyetjen të qartë, mund të përdoren fotografitë ose ndihma të tjera vizuale.

## STUDIM MODEL

Përdorimi i pyetësorëve në shkollë – si të kuptojmë shfrytëzimin seksual në zonat me rrezik të madh të Sri-Lankës, Miles (2000a)

Në zonat bregdetare me rrezik të madh në Sri-Lankë po shfrytëzohej seksualisht një numër fëmijësh, por madhësia e problemit ishte e paqartë. Për të gjetur këtë informacion, u vendos që të pyeteshin vetë fëmijët. Diskutimi ballë për ballë me fëmijët për një temë kaq të ndjeshme u konsiderua joetik dhe i papërshtatshëm. Sidoqoftë, meqë nivelet e shkrim-këndimit ishin të larta, u arrit në përfundimin se mund të përdorej një pyetësor me shkrim. Ky pyetësor duhej të ishte sekret dhe fëmijët mund të merrnin pjesë vetëm nëse kishin dëshirë.

Pas marrjes së lejes nga autoritetet dhe shkollat, u hartua një pyetësor. Një nga pyetjet e bëra ishte nëse fëmijët njihnin të tjerë moshatarë në atë zonë që ishin abuzuar nga të rriturit. Po kështu, fëmijët u pyetën se çfarë mendonin për zgjidhjet e mundshme. Pyetësori u testua me një grup fëmijësh për t'u siguruar nëse pyetjet mund të kuptoheshin.

Rezultatet e pyetësorit treguan nivelin e shfrytëzimit seksual në këtë zonë me rrezik të lartë, si dhe pikëpamjet e fëmijëve për të. Për shembull, një djalë tha: "Fëmijët nuk bëjnë seks me të rriturit për qejf." Rezultatet u përdorën kur u bë lobing te qeveria për nevojën e trajtimit të kësaj çështjeje.

## STUDIM MODEL

Përdorimi i anketimeve në komunitete – si të kuptojmë aksesin e pornografisë për fëmijët në Kamboxhian urbane

Në Kamboxhia ekzistonte shqetësimi se fëmijët kishin akses për të parë pornografi. Me qëllim që të përftohej informacion nga fëmijët që s'ishin në gjendje të lexonin, u krye një anketim i thjeshtë, i cili përdori vizatime që tregonin se në ç'vende mund të gjendeshin materiale të tilla. Për të ndihmuar në zhvillimin e anketimit, me qëllim që të siguroheshin se do të përdoreshin pyetje të mira dhe gjuhë e përshtatshme, u përdorën grupet e fokusit.

Në anketim morën pjesë fëmijë të moshave 11–17 vjeç. Rezultatet iu çuan një grupi fëmijësh të së njëjtës moshë për t'u marrë mendimet. Më pas ata ndihmuar në zhvillimin e një produksioni teatral për adoleshentë, që fliste për aksesin që kanë fëmijët për pornografi, i cili u luajt në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve.

Raporti iu shpërnda palëve kyçe të interesit, duke përfshirë qeverinë dhe OJQ-të, dhe ndihmoi në rritjen e ndërgjegjësimit për këtë çështje. Ende mbetet shumë për të bërë në mënyrë që ligjet të ndryshohen.



Një nga vizatimet e përdorura në anketim

## Reflektim

- Çfarë teknikash anketuese përdorim tani? Si mund të përshtaten për përdorim nga fëmijët?
- Anketimi në studimin model të Kamboxhias u përdor për teatër dhe mbrojtje. Në çfarë mënyrash të tjera mund të përdoren pyetësorët dhe anketimet?

**Metodat vizuale**

Përshtatur nga  
Boyden dhe Ennew  
(1997)

Mund të jetë më e lehtë dhe më pak kërcënuese nëse përdoren metodat vizuale kur mbledhim informacion nga fëmijët. Këto metoda përfshijnë: vizatimin, pikturimin, bërjen e modeleve, kukullave, fotografive dhe videove.

Sidoqoftë, metodat vizuale nuk janë të përshtatshme, nëse:

- ka gjasa që ato të zgjojnë kujtime ose mendime të dhembshme me të cilat fëmijët nuk do të jenë në gjendje të përballen;
- fëmijët nuk janë mësuar me imazhe vizuale;
- përdorimi i lapsit, i stilolapsit apo i ndonjë mjeti tjetër i bën fëmijët të mos ndihen rehat;
- disa imazhe të përdorura nuk janë të përshtatshme nga ana kulturore;
- kërkuesit nuk e kuptojnë mënyrën si e shohin fëmijët botën e tyre;
- fëmijët s'kanë mundësi që të shpjegojnë ose të interpretojnë imazhet që kanë krijuar;
- mjeti i përdorur tërheq më tepër se ç'duhet vëmendjen e publikut, si për shembull kamerat;
- bërja e një incizimi vizual mund të përbënte rrezik sigurie për fëmijët dhe kërkuesit.

**Vizatimi**

Fëmijëve zakonisht u pëlqen vizatimi. Kur u kërkon atyre që të vizatojnë, kërkuesi është në gjendje ta reduktojë fuqinë dhe kontrollin e tij dhe t'u japë fëmijëve më tepër liri shprehjeje. Me qëllim që të shmanget mundësia e keqinterpretimit të vizatimeve, është e rëndësishme që kërkuesi të sigurohet që interpretimi të bëhet nga vetë fëmijët. Leja e përdorimit ose kopja e vizatimeve duhet marrë nga fëmijët që i kanë vizatuar.

Përveç kryerjes së vizatimeve, fëmijëve mund t'u kërkohet që të vizatojnë harta, diagrame dhe tabela për të eksploruar komunitetin, marrëdhëniet e tyre, si dhe përdorimin që i bëjnë kohës dhe hapësirës.

STUDIM  
MODEL

Përdorimi i vizatimeve në Mianmar, Miles (2000b)

Mjeti i mëposhtëm është përdorur me fëmijët në një sërë kontekstesh:

- Fëmijë që kanë qenë dikur ushtarë;
- Fëmijë që kanë qenë dikur punëtorë seksi;
- Fëmijë në përkujdesje afatgjatë në jetimore;
- Fëmijë që u kanë vdekur prindërit nga SIDA.

Fëmijëve iu kërkua që të bënin tri vizatime për veten: një për të shkuarën, një për të tashmen dhe një për të ardhmen dhe, më pas, t'ua shpjegonin ato të rriturve. Të rriturit u treguan të respektueshëm, nuk i ndërprejnë dhe i nxitën fëmijët të flisnin kur po u tregonin për vizatimet. Fëmijët u ftuan që të merrnin pjesë, por mund të largoheshin në çdo moment nëse ndiheshin në siklet.

Për shumë fëmijë kjo ishte e para herë që të rriturit ishin përgatitur t'i dëgjonin. Ata u inkurajuan nga ndryshimet që kishin bërë nga e kaluara dhe për shpresat që kishin për të ardhmen.

Të rriturit e kuptuan se secili fëmijë është unik. Për shembull, ndonëse, më parë, disa të rritur kishin parë informacione historike për fëmijët nga dosjet e tyre, ata nuk i kishin menduar fëmijët si njerëz me të ardhme. Të rriturit ia dolën të kuptonin më mirë se si e shikonin fëmijët situatën e tyre.

## Reflektim

- A jemi të përkushtuar që t'ua vëmë veshin fëmijëve në punën tonë?
- A i konsiderojmë si individë me frikën, me nevojat, me shpresat e veta?
- Si mund t'i dëgjojmë fëmijët në mënyrë më të efektshme?

Fotografitë  
dhe videot

Fëmijët nga të gjitha kulturat mësojnë shpejt të përdorin kamerat dhe pajisjet video. Ato janë popullore dhe sigurojnë një mundësi për t'i kapur imazhet nga brenda botës së një fëmije. Ato u sigurojnë fëmijëve një mjet krijues për të paraqitur jetën në mënyrë pozitive.

Kamerat mund të jenë të shtrenjta, kështu që duhet vlerësuar fakti sa i rëndësishëm mund të jetë përdorimi i fotografive. Aparatet fotografike njëpërdorimshe mund të përdoren në situata ku fëmijët kanë nevojë të bëjnë fotografi pa mbikëqyrje.

STUDIM  
MODEL

Ditarët me fotografi – fëmijët dokumentojnë jetën e komunitetit të tyre në Indinë e Jugut, Stephenson (1998a)

Disa fëmijëve të klubit të fëmijëve të fshatit u dhanë aparate fotografike njëpërdorimshe dhe i trajnuan se si t'i përdornin ato. Kjo ishte e para herë që ata kishin bërë fotografi. Iu kërkua që të dokumentonin jetën e tyre të përditshme, si dhe të bënin fotografi të atyre gjërave që mendonin se ishin të mira dhe të këqija në fshat. Vetë fëmijët vendosën se cilët fëmijë duhej të kryenin fotografitë dhe cilat fotografi duheshin kryer.

Fotografitë u analizuan nga të gjithë fëmijët e klubit. Ata i renditën aktivitetet e përditshme sipas parapëlqimeve. Diskutuan gjërat e mira dhe të këqija të shfaqura në fotografi dhe ranë dakord për çështjet më të rëndësishme. Këto u përdorën për të krijuar planin e veprimtimit që klubi i fëmijëve duhej të kryente gjatë vitit në vijim.

### Skeçet dhe drama

## STUDIM MODEL

Përdorimi i skeçeve – si të kuptojmë pikëpamjen që kanë fëmijët për dhunën në Kamboxhia

Miles dhe Varin (2004)

### Reflektim

Videokamerat janë të shtrenjta. Teknologjia mund të pësojë avari dhe puna me regjistrimet mund të kërkojë një kohë të gjatë dhe të bëhet e ndërlikuar. Videokamerat është më mirë të përdoren si mjet për të dokumentuar një mbrojtje të drejtash ose për të rritur ndërgjegjësimin. Përgatituni për këtë duke pasur videokaseta dhe bateri shtesë me bollëk.


Interpretimi i roleve dhe drama mund të ndihmojnë fëmijët që të eksplorojnë çështje të ndjeshme dhe të rëndësishme. Përdorimi i kukullave dhe i maskave mund t'u lejojë fëmijëve që të shprehin pikëpamje për çështje të ndjeshme, pa iu dashur që qysh në fillim të flasin për përvojat e tyre traumatike.

Kamboxhia ka një histori të gjatë dhune. Shumica e punëve kërkimore është përqendruar te rastet e skajshme dhe jo te dhuna që prek fëmijët e zakonshëm në shtëpi dhe në shkollë. Fëmijët në Kamboxhia priren të tregohen të ndrojtur para të rriturve; nuk është zakon që ata t'i pyesin për t'u marrë mendimet. Sidoqoftë, skeçet janë diçka që fëmijëve u pëlqen. Ato mund të përdoren për të përftuar një njohje të pikëpamjeve të tyre.

Fëmijët u ftuan të merrnin pjesë në interpretime rolesh të bazuara në gjashtë vizatime të bëra nga një artist lokal. Skeçet u incizuan në video dhe pastaj u panë si film për të inkurajuar diskutimin.

Gatishmëria e fëmijëve për t'u hapur dhe për të shprehur pikëpamjet e tyre duke përdorur këtë metodë ishte habi për lehtësuesit. Ata kishin qenë të preokupuar se mos djemtë dhe vajzat nuk do të punonin mirë së bashku, por ja që e bënë. Në çdo grup kishte nga dhjetë fëmijë, që do të thoshte se ata fëmijë që nuk donin të merrnin pjesë, nuk ishin të detyruar ta bënin.

Rezultatet e ushtrimit me interpretim rolesh u përdorën për të zhvilluar një anketim për fëmijët e shkollës, i cili tani po kryhet në mbarë Kamboxhian.



Një nga vizatimet në bazë të të cilit u bë një interpretim roli.

- Pse janë të dobishme dramat dhe interpretimi i roleve?
- Si mund të quhet e mirë një dramë apo interpretimi i një roli?

### Regjistrimi i informacionit

**MBAJTJA E SHËNIMEVE** – Gjatë çdo diskutimi që kryhet (intervista, grupe fokusi dhe interpretime të skeçeve dhe të vizatimeve), si dhe për çdo vëzhgim, duhen mbajtur shënime. Atje ku është e mundur duhet shkruar më tepër sesa thuhet. Duhet mbajtur shënim dinamika e diskutimeve, shenjat e trupit dhe emocionet. Është e rëndësishme të siguroheni që të mbahen shënim detajet e datave, kohës, vendit dhe emrat e pjesëmarrësve.

**DOKUMENTET** – Kopjet e vizatimeve, fotografive dhe të hartave e të diagrameve të tjera duhen etiketuar dhe futur në dosje. Nëse hartat ose diagramet përdorin materiale lokale, duhet bërë një vizatim në letër me qëllim që të sigurohet regjistrimi i detajeve.

## Analiza dhe përdorimi i informacionit kërkimor

Informacioni duhet analizuar bashkë me fëmijët ose nga ata. Pastaj mund të përdoret në disa mënyra të ndryshme:

- Rezultatet mund të përdoren për të planifikuar një projekt komuniteti që trajton çështjet me të cilat përballen fëmijët. Fëmijët duhen ftuar në planifikimin dhe zbatimin e projektit.
- Si pjesë e punës mbrojtëse të të drejtave, zyrtarëve të qeverisë mund t'u tregohet një raport ose dokumentar filmik.
- Mund të përdoret një ekspozitë fotografish ose vizatimesh për të rritur ndërgjegjësimin dhe profilin e punës së një organizate ose projekti të veçantë.
- Informacioni mund të përdoret nga fëmijët për nevojat e tyre.

Klubi i Fëmijëve *Chisomo* në Malavi është një shembull i mirë i përdorimit të mjeteve pjesëmarrëse për të ndihmuar identitetin e fëmijëve dhe për të planifikuar projektet.

Aktivitetet përfshijnë:

- vizatimin e hartave, që tregojnë vende të rrezikshme dhe vende plot mundësi për ta;
- kryerjen e vizatimeve për çështje specifike që i shqetësojnë fëmijët, si ngacmimi nga policia ose dhuna në familje;
- idetë e çastit dhe, pastaj, renditja e problemeve sipas rëndësisë;
- analizimin e përdorimit që i bëjnë kohës, duke përdorur diagramet;
- vizatimin e kalendarëve sezonalë të shëndetit të tyre të lig;
- vizatimin e pemëve të sigurimit të të ardhurave, të cilat tregojnë se ku e marrin parandë dhe si e shpenzojnë.

Këto metoda i aftësojnë fëmijët që të kuptojnë çështjet me të cilat përballen dhe të gjejnë së bashku zgjidhjet. Ata kanë ndihmuar në përzgjedhjen e tokës për tri qendrat e *Chisomo-s* dhe në bërjen e planit të godinave, si dhe identifikimin e përdorimit të tyre. Fëmijët janë të përfshirë në procesin e mbrojtjes së të drejtave, rekrutimin e stafit dhe vlerësimin e projekteve.

Pasi mblidhet informacioni parësor dhe dytësor, fëmijët duhen përfshirë në planifikimin e projektit. Fëmijët më të rritur mund të jenë në gjendje të ndihmojnë në zhvillimin e një kornize logjike dhe të përfshihen në bërjen e buxhetit.

- Kur i kërkojmë një grupi fëmijësh të analizojë informacionin që na ka dhënë ose ka mbledhur për ne:
  - Si mund të inkurajojmë fëmijët më të heshtur që të marrin pjesë?
  - Si mund të mos i lejojmë disa fëmijë që të dominojnë bisedën?
  - Si mund të ndihmojmë në zgjidhjen e konflikteve që mund të ndodhin?
  - Si mund të sigurohemi se idetë po i nxjerrim nga fëmijët dhe nuk po u futim idetë tona në kokën e tyre?
  - Si mund të përfshijmë fëmijët në planifikimin e projektit?

## STUDIM MODEL

Klubi i Fëmijëve  
*Chisomo*

Reflektim

### 4.3. Zbatimi dhe vlerësimi

Pasi fëmijët përfshihen në identifikimin dhe hartimin e projektit, ata duhet të përfshihen edhe në zbatimin dhe vlerësimin e tij.

Është e rëndësishme të sigurohemi që fëmijët:

- të kenë një rol në aspektet organizative të projektit;
- të marrin një rol aktiv në përfaqësimin e projektit;
- të përfshihen në monitorimin dhe shqyrtimin e ecurisë së projektit sipas objektivave që ka;
- të vlerësojnë ndikimin e projektit në jetën e tyre.

Paragrafët e mëposhtëm i shqyrtojnë këto çështje në më tepër detaje.

#### Fëmijët marrin një rol në aspektet organizative të punës

Me qëllim që të sigurohemi se fëmijët mund të marrin pjesë në drejtimin e një projekti, lini kohë të mjaftueshme për diskutim të rregullt të vendimeve të projektit, si për shembull: kur vendosni për vendndodhjen dhe zbulimin e qendrave rinore, punësimit të stafit dhe rënien dakord për buxhetet. Kjo mund të kërkojë takime javore ose mujore.

#### SHEMBUJ

**Takimet mujore.** *Mosoj Yan* në Bolivi punon me vajzat që jetojnë ose punojnë në rrugë. Vajzat mbajnë takime mujore ku përfshihen në vendimet për projektet e *Mosoj Yan* dhe në vlerësimin e ecurisë.

**Këshillat e zgjedhur.** Fëmijët në *Namma Boomi*, qendër trajnuese e të Preokupuarve për Fëmijët në Punë, zgjedhin çdo vit komitetin e fëmijëve dhe presidentin. Komiteti vepron për përmirësimin e kushteve dhe projekteve në qendër.

#### Fëmijët luajnë një rol aktiv në përfaqësimin e projektit

Shpesh organizatat për zhvillim vizitohen nga donatorë dhe zyrtarë të qeverisë. Një metodë e zakonshme për t'u dhënë mirëseardhjen është t'i bëjnë fëmijët të këndojnë ose të vallëzojnë për ta. Më pas, vizita vazhdon me një parashtrim që të rriturit u bëjnë të rriturve për punën e bërë me fëmijët. Mendoni sesi vetë fëmijët mund të organizojnë së bashku një program mirëseardhjeje që mund të përfshijë edhe prezantimin e projektit para donatorëve dhe vizitorëve të tjerë. Kjo mund të sfidojë perceptimin e fëmijëve nga ana e stafit, donatorëve dhe vizitorëve.

Organizatrat që punojnë me fëmijët, normalisht përfaqësohen në konferenca nga stafi i të rriturve. Mendoni për mundësinë e përzgjedhjes së disa fëmijëve që të vijjnë në konferencë me anëtarët e stafit.

**SHEMBUJ**

**MANTHOC, Lima, Peru** – Fëmijët nga Lëvizja e Fëmijëve në Punë përshëndesin vizitorët në MANTHOC. Pastaj ata u tregojnë atyre lagjen dhe u përgjigjen pyetjeve për programin. Një përfaqësues i rritur nga MANTHOC është gjithmonë me fëmijët, por nuk bën asnjë përpjekje për të kontrolluar bisedën.

**Bhima Sangha, Indi** – Fëmijët nga Sindikata e Fëmijëve në Punë *Bhima Sangha* përfaqësojnë rregullisht Sindikatën nëpër konferenca ndërkombëtare. Këta fëmijë përzgjidhen nga fëmijë të tjerë për të përfaqësuar shqetësimet dhe idetë e Sindikatës. Të rritur nga të Preokupuarit për Fëmijët në Punë i shoqërojnë fëmijët dhe u sigurojnë mbështetje, përkthim dhe udhëzim.

### Fëmijët përfshihen në monitorimin dhe në analizimin e ecurisë së projektit drejt përmbushjes së objektivave.

**Monitorimi** bëhet vazhdimisht për t'u siguruar se projekti është në udhë të mbarë. Asamble ose këshilla të organizuar fëmijësh mund të mundësojnë kryerjen e monitorimit. Një takim mujor për të diskutuar ecurinë mund të sigurojë që aktivitetet po kryhen sipas planit.

**Analiza** bëhet herë pas here për të parë nëse secili nivel objektivash në kornizën logjike çon te niveli i radhës dhe nëse duhet bërë ndonjë ndryshim në planet e projektit. Për shembull, analiza mund të bëhet një herë në gjashtë muaj.

**STUDIM  
MODEL**

Analiza e identitetit dhe e qëllimit të një klubi fëmijësh në Malavi

“*Chisomo* është organizatë fëmijësh që ndihmon fëmijët të kenë një të ardhme më të mirë, njeh të ardhmen e tyre dhe siguron nevojat e tyre”, – kështu e përshkruan Klubin e Fëmijëve *Chisomo* fëmijët e rrugëve të *Blantyre-s* në Malavi gjatë një analize pjesëmarrëse që kryente stafi në vitin 2002. Fëmijët e themeluan identitetin e *Chisomo-s* kur klubi u hap më 1998. Sidoqoftë, ekzistonte mundësia që, me kalimin e kohës, klubi mund të evoluonte në një organizatë të drejtuar nga të rriturit, me pak kontribut nga fëmijët. Prandaj analiza e vitit 2002 u krye me qëllim që të qartësohej misioni, synimi dhe vlerat e *Chisomo-s*.

Analiza shqyrtoi se çfarë është *Chisomo*, përse ekziston dhe çfarë e bën të ndryshëm nga organizatat e tjera. Për këtë qëllim iu kërkua fëmijëve që kishin qenë atje qysh në fillim, të tregonin historinë e tyre sesi e mori emrin *Chisomo*, çfarë kishin bërë vetë ata dhe kush i kishte marrë vendimet. Me kryerjen e analizës, *Chisomo* filloi të ripërcaktonte veten si organizatë fëmijësh. Fëmijët theksuan se atyre nuk u ishin dhënë gjërat e gatshme, por ia dilnin të përmbushin vetë nevojat dhe të zhvillonin aftësitë dhe njohurinë e tyre për të ardhmen. Ata ishin të kënaqur që projekti ishte bazuar në fjalën dhe në lutjen e Perëndisë, dhe i ndihmoi që t'i shpëtonin abuzimit.

**SHEMBUJ**

Analiza e aktiviteteve të një programi kishe për arsimin

Shërbesat *Lifestream* në Filipine punojnë me fëmijë nga komunitetet e varfra të qytetit. Programet e tyre sigurojnë mbështetje shëndetësore, mësimore, shoqërore, emocionale, fizike dhe shpirtërore për më tepër se 580 fëmijë. Në vitin 2001, shërbesat *Lifestream* filluan që t'u mësonin fëmijëve konventën “Për të drejtat e fëmijëve” dhe të merrnin seriozisht parimin e pjesëmarrjes në aktivitetet e tyre planifikuese dhe vlerësuese.

Procesi i një analize vjetore u mundëson fëmijëve të ndihmojnë në zhvillimin e planit vjetor të aktiviteteve. Po kështu, atyre u kërkohet që të analizojnë aktivitetet e vitit të shkuar dhe të vlerësojnë punën e mësuesve. Fëmijët përzgjedhin përfaqësues që të marrin pjesë në një seminar dyditor.

Aktivitetet që kryen fëmijët në seminar përfshinë:

- Shqyrtimin se përse ishte e rëndësishme të vlerësohej ajo që kishte ndodhur vitin e shkuar.
- Shqyrtimin e vitit të shkuar dhe vlerësimin e jetës së tyre personale: çfarë kishin bërë mirë, gabimet që kishin bërë, çfarë kishin nxënë dhe zbatuar në jetë, si u kishte ndryshuar jeta dhe si ishte marrëdhënia e tyre me Perëndinë dhe të tjerët. Fëmijëve iu dha një fletore ku të shënonin vetëvlerësimin e tyre.
- Analizën e planit për vitin e shkuar. U përdorën katër copa letre me ngjyra të ndryshme. Secila prej tyre përfaqësonte një pjesë të shkallës vlerësuese për të treguar nëse ishte kryer zbatimi i secilit aktivitet. Shkalla vlerësuese ishte: “i zbatuar mirë”, “i zbatuar”, “i zbatuar pjesërisht”, “i pazbatuar”. Pjesëmarrësit i shkruan aktivitetet një nga një në copat e letrave, sipas mendimit të tyre sesi ishte kryer çdo aktivitet.
- Vlerësimin e punës së mësuesve. Për këtë, u zhvillua një grup treguesish nga mësuesit dhe vullnetarët. Treguesit u shkruan në një diagram me kuti sipas nivelit: nëse treguesi ishte përmbushur plotësisht, pjesërisht, dobët ose aspak. Secilës klasë iu dha nga një kopje. Secilit fëmijë në klasë iu kërkua që të vlerësonte mësuesin sipas shkallës që ai/ajo kishte përmbushur treguesin e ecurisë. Ata vendosën nga një pullë ngjitëse te kutia e duhur. Në klasat me fëmijë më të vegjël, lehtësuesi ua lexonte treguesin që duhej vlerësuar dhe ua shpjegonte kuptimin. Rezultatet e analizës u shqyrtuan nga fëmijët dhe nga stafi dhe ia paraqitën mësuesve. Si përgjigje ndaj këtyre rezultateve, mësuesit zhvilluan një plan për përmirësimin e ecurisë së punës.

Gjatë këtij procesi u mësuan shumë gjëra.

#### **Fëmijët:**

- u rritën në aftësinë e tyre për të shprehur ide, për të bërë sugjerime, për të bërë pyetje dhe për të ndarë problemet;
- fituan siguri në vetvete;
- u rritën në aftësinë për të vlerësuar ecurinë e shërbesave *Lifestream* dhe mësuesve të tyre;
- u bënë më të ndërgjegjshëm për standardet e ecurisë së punës që kërkohen për mësuesit;
- u bënë më të ndërgjegjshëm për vlerën e analizës së planeve dhe mësuesve të tyre dhe për kontributin e tyre në përmirësimin e përgjithshëm të programit.

#### **Mësuesit:**

- u bënë më të ndërgjegjshëm për nevojën e tyre që të jenë të përgjegjshëm para fëmijëve për të kryer një mësimdhënie me cilësi të mirë dhe për të shërbyer si modele për fëmijët në jetë;
- e kuptuan se fëmijët mund të japin informacione të rëndësishme dhe të vlerësojnë parapëlqimet e tyre.



STUDIM  
MODEL

Fuqizimi i  
fëmijëve të  
rrugës në  
Mianmar  
përmes  
vlerësimit  
pjesëmarrës

Dorning dhe  
O'Shaughnessy  
(2001)

**Shërbesat Lifestream:**

- vendosën t'i bënin fëmijët pjesë të procesit të vlerësimit paraprak dhe përfundimtar jo vetëm të mësuesve, por edhe të të gjitha proceseve të ndërmarrja nga programi;
- vendosën t'i përshtatnin mjetet më tej për përdorim me fëmijët më të vegjël.

**Fëmijët vlerësojnë ndikimin e projektit në jetën e tyre**

Në dallim nga monitorimi dhe analiza, vlerësimi përfundimtar kryhet në fund të projektit për të parë ndikimin e tij. Vlerësimi pjesëmarrës u bën të mundur palëve kryesore të interesit që të vlerësojnë nëse është arritur qëllimi dhe synimi i projektit, dhe që të sugjerojnë ndryshime kryesore në strategjinë dhe punën e ardhshme. Metodat e përdorura duhet të pasqyrojnë moshën dhe përvojën e fëmijëve të përfshirë në vlerësim.

Projekti i Fëmijëve të Rrugës dhe në Punë i World Vision në Jangon dhe Mendelej, Mianmar, synon të përmirësojë cilësinë e jetës dhe statusin e fëmijëve të rrugës dhe në punë, dhe t'i integrojë sërish në shoqëri. Po kështu, ai synon të trajtojë çështje që i shtynë fëmijët të dalin në rrugë në Jangon.


Në vitin 2001 u krye vlerësimi përfundimtar i programit. Vlerësimi synonte të maste ndikimin e programit dhe të identifikonte mënyrat sesi fëmijët dhe stafi mund ta vlerësonin dhe ta përmirësonin në të ardhmen. Deri në kohën e vlerësimit, pjesëmarrja e fëmijëve në projekt kishte qenë e kufizuar. Vlerësimi ndoqi hapat e mëposhtëm:

1. **ZGJEDHJA E SKUADRËS SË VLERËSIMIT** – Fëmijët zgjodhën 16 fëmijë për të qenë anëtarë të skuadrës së vlerësimit.
2. **TAKIMET FILLESTARE** – Stafi dhe fëmijët u mbledhën së bashku për të dhënë ide të atypëratyshme për të krijuar një listë pyetjesh. U identifikuan palët kryesore të interesit dhe u mbajtën takime me ta.
3. **PYETJET** – Për çdo grup pale interesi u zhvilluan pyetje që fokusoheshin te motivimet dhe interesat e tyre specifike.
4. **ZGJEDHJA E PYETJEVE** – Nga listat, u përzgjedhën tetë pyetje kryesore.
5. **PLANIFIKIMI I INTERVISTAVE** – Skuadra e vlerësimit planifikoi në detaje intervistat, duke përcaktuar detyrat e gjithsecilit, si dhe vendin dhe kohën e tyre. Pyetjet u grupuan sipas grupeve të veçanta të fokusit.
6. **UDHËZUESIT E PYETJEVE** – Për intervistuesit u hartua një libër udhëzimesh, për t'u dhënë këshilla për kohën, pjesëmarrësit dhe mbajtjen e shënimeve.
7. **TRAJNIMI** – Fëmijët dolën vullnetarë për t'u bërë intervistues dhe u trajnuan për të lehtësuar grupe fokusit.
8. **ZBATIMI** – U formuan skuadrat e intervistave, u hartuan grafikët e punës dhe udhëzuesit e pyetjeve. U kryen intervistat dhe grupet e fokusit. Nga regjistrat e zyrës u mblodh informacioni dytësor për projektin.
9. **REZULTATET** – Skuadra e vlerësimit organizoi një seminar treditor. Rezultatet u paraqitën në mënyra pjesëmarrëse dhe vizuale. U krye një analizë FDMK (pikat e forta, të dobëta, mundësitë dhe kërcënimet) duke përdorur informacionin nga grupet e fokusit.
10. **REKOMANDIMET** – Seminari përfundoi me rekomandime kyçe për projektin, përfshi dhe një proces hap pas hapi për të arritur disa prej tyre.

**Mjetet e vlerësimit:**

Grupet e fokusit dhe intervistat e përdorura nga World Vision Mianmar janë mjetet kyçe të vlerësimit. Për qëllime vlerësimi, mund të përshtaten edhe shumë prej mjeteve pjesëmarrëse të përmendura tashmë në këtë libër. Në kutinë e mëposhtme përshkruhen dy mjete të tjera.

**Vijat e vetëbesimit** tregojnë se si ka ndryshuar vetëbesimi i një personi me kalimin e kohës, si për shembull gjatë një projekti. Në grafikun e mëposhtëm pjesëmarrësit vizatojnë vijën e tyre të vetëbesimit. Atje ku vija ulet shumë ose ngrihet së tepërmi, atyre u kërkohet të tregojnë se çfarë ndodhie specifike i shkaktoi këto ndryshime. Vija e vetëbesimit siguron bazën për diskutimin me lehtësuesin.



**Vija e vlerësimit** mund të përdoret si mjet vlerësimi për fëmijët më të rritur. Pjesëmarrësve u kërkohet të mendojnë për një pyetje, si për shembull “Me sa sukses i ke përmbushur objektivat e tu?” Ata e vlerësojnë suksesin e tyre mbi një vijë që varion nga *aspak* deri te *plotësisht*. Pastaj, u kërkohet të shkruajnë të gjitha arsyet pse i kanë arritur ose jo këta objektiva. Pasi diskutojnë përgjigjet dhe çështjet që dalin nga kjo, pjesëmarrësit shkruajnë veprimet e mundshme që mund të ndihmojnë në përmbushjen e këtyre objektivave. Kjo metodë funksionon mirë në grupe me 10–20 veta.

## Reflektim

- Si mund t’u bëjmë të mundur fëmijëve të luajnë një rol në aspektet organizative të punës sonë?
- Si i përfshijmë fëmijët kur na vijnë vizitorë për të parë projektin tonë?
- Si mendojmë se do të na përmirësoheshin projektet nëse i përfshijmë fëmijët në monitorimin dhe analizën e ecurisë së kryer?
- Çfarë ndryshimesh duhet të bëjmë për t’u bërë fëmijëve të mundur të analizojnë, të monitorojnë dhe të vlerësojnë ndikimin e projektit në jetën e tyre?

## 4.4.

## Festimi dhe dokumentimi i mësimeve të marra

Fëmijët dinë si të festojnë! Fryma e zbavitjes dhe e lirshmërisë duhet të jenë aspekt i të gjithë punës me fëmijët. Të rriturit prirën të jenë më të fokusuar në rendimentet dhe rezultatet, ndërsa fëmijëve u pëlqen procesi. Të gjithë duan rezultate të mira; duhen krijuar mundësi për të kremtuar suksesin dhe mësuar nga gabimet.

Festimet duhet të ofrojnë një mundësi për krijimtari dhe shprehje kulturore. Refugjatët ruandas në Tanzani festuan fundin e një cikli projekti të lehtësuar nga Skuadra e Reagimit ndaj Fatkeqësive të *Tearfund* duke sjellë vallëzime, këngë dhe punëdore që shprehnin aktivitetet e ndryshme ku ishin përfshirë. Vizatimet, pikturat dhe fotografitë mund të ekspozohen edhe në komunitet. Gjithashtu, mund të përdoren dhe skeçe për të treguar pikat e forta dhe të dobëta të projektit.

“Fatkeqësisht, si debateve, ashtu dhe punës kërkimore për pjesëmarrjen e fëmijëve, u mungon dokumentacioni sistematik. Neve na nevojiten regjistrime të mënyrës si janë bërë gjërat, jo thjesht të gjërave të kryera, përfshi dhe mësime nga gabimet.” (*Ennew 2002*)

Të pakta janë organizatat që dokumentojnë mësime të marra nga projektet. Kjo është e vërtetë sidomos për atë që është mësuar nga pjesëmarrja e fëmijëve. Ne mund të vendosim:

- Të shkruajmë një buletin lajmesh bashkë me fëmijët, i cili përshkruan atë që është arritur. Për shembull, *Bhima Sangha* krijoi një “gazetë muri” që u modelua dhe u shkrua nga fëmijët. Gazeta u ngjit nëpër mure në të gjithë fshatin. Ajo përmbante informacion për fëmijët dhe të rriturit në lidhje me çështje shëndeti dhe lokale. Aty përfshiheshin vizatime satirike dhe artikuj.
- Të shkruajmë një dokument ku skicohet ajo që është mësuar për ndërveprimin mes fëmijëve dhe të rriturve.
- Të inkurajojmë fëmijët që të dokumentojnë përvojën dhe nxënien e tyre. Për shembull, fëmijët nga *Bhima Sangha* regjistruan historinë dhe përvojat e tyre me qëllim që të përfaqësonin kuptimin e vërtetë për jetën e tyre.

Fëmijët rriten! Përjasjet dhe kultura pjesëmarrëse e nxënë nga njëri brez fëmijësh mund të ndahet me brezin tjetër. Dokumentacioni i asaj që është bërë dhe nxënë mund të ndahet me fëmijë të rinj me të cilët po punon organizata jonë, siç tregon studimi model i mëposhtëm.

**STUDIM  
MODEL**

Vija kohore

Stephenson (1998b)  
dhe *Footsteps* 58,  
f. 8-9

Fëmijët nga *Bhima Sangha* në Indi donin një mjet që ta përdornin për të dokumentuar atë që kishin arritur në tetë vjetët e fundit. Ata vendosën të krijonin një murale të madhe në letër me vizatime të ngjarjeve të rëndësishme.

**HAPI I PARË** – Një sërë anëtarësh të *Bhima Sangha*-s u përzgjedhën nga fëmijë të tjerë për të vizatuar vijën kohore.

**HAPI I DYTË** – Fëmijët e përzgjedhur gjetën gjithë dokumentet për historinë e tyre dhe vendosën se cilat ngjarje duheshin pasqyruar në vijën kohore.


**HAPI TRETË** – Ata ngjitën disa fletë të mëdha së bashku dhe filluan të skiconin muralen.

**HAPI I KATËRT** – Muralja u plotësua dhe u përdor për të orientuar anëtarët e rinj të *Bhima Sangha*-s.

Vija kohore ishte kaq e suksesshme, saqë *Bhima Sangha* vendosi ta kopjonte mbi një pëlhurë të madhe dhe të shtonte ngjarje të reja në çdo gjashtë muaj. Pëlhura u përdor për të orientuar vizitorët dhe anëtarët e rinj dhe për të rritur ndërgjegjësimin për Sindikatën. Një tjetër version i vijës kohore u pikturoa mbi një mur të ndërtuar posaçërisht për këtë gjë në qendrën e trajnimit.

**DISA NGA VIZATIMET E PËRDORURA NË VIJËN KOHORE TË BHIMA SANGHA-S**


1. Përkatësia në *Bhima Sangha*



2. Maratona e ecjes



3. Incidenti në hotel "Ayodhya"



4. Konsultimi rajonal, 1996



5. Programi i ndërtimit



6. Pançajetet makkala (këshillat e fëmijëve)



# Burimet

## Bibliografia

- Blackman, R. (2003). *ROOTS 5: Project cycle management* [Menaxhimi i ciklit të projektit]. Tearfund.
- Boyden, J. dhe Ennew, J. (1997). *Children in Focus – A Manual for Participatory Research with Children* [Fëmijët në fokus – Manual për hulumtim pjesëmarrës me fëmijët]. Save the Children, Stockholm.
- Dorning, K. dhe O’Shaughnessy, T. (2001). *Creating space for children’s participation: Planning with street children in Myanmar* [Krijimi i hapësirës për pjesëmarrjen e fëmijëve: Planifikimi me fëmijët e rrugës në Mianmar]. World Vision, Australia.
- Kirby, P. (1999). *Involving Young Researchers – How to enable young people to design and conduct research* [Përfshirja e kërkuesve të rinj – Si të aftësoni të rinjtë për të hartuar dhe për të kryer hulumtimet]. Joseph Rowntree Foundation, York, dhe Save the Children, London.
- McIvor, C. (2001). Do not look down on us: child researchers investigate informal settlements in Zimbabwe [Mos na nënçmoni: fëmijët hulumtues hetojnë banimet informale në Zimbabve]. *PLA notes* 42 IIED.
- Miles, G. (2000a). Children don’t do sex with adults for pleasure: Sri Lankan views on sex and sexual exploitation. *Child Abuse and Neglect* [Fëmijët s’bëjnë seks me të rriturit për kënaqësi: pikëpamje nga Sri-Lanka për seksin dhe shfrytëzimin seksual. Abuzimi dhe neglizhimi i fëmijëve], Vëll. 24, nr. 7, f. 995-1003.
- Miles G. (2000b). Drawing together hope: Listening to militarised children *Journal of child health care* [Bashkimi i shpresës: Dëgjoni fëmijët e militarizuar. Revista e kujdesit shëndetësor për fëmijët], Vëll. 4, nr. 4, f. 137-142.
- Miles, G. dhe Varin, S. (2004). *Tell them to stop!: Prevalence and perceptions of Cambodian children of child sexual abuse* [U thoni të ndalojnë!: Mbizotërimi dhe perceptimet e fëmijëve kamboxhianë për abuzimin seksual të fëmijëve]. Child Welfare Group/ Tearfund.
- Ramachandran, V. dhe Saihjee, A. (2001). *Looking Back in Order to Look Ahead: The Concerned For Working Children (CWC) An External Review* [Vështrimi pas për të parë përpara: Të shqetësuarit për fëmijët në punë – një analizë e jashtme]. Educational Research Unit, New-Delhi/Jaipur.
- Ritchie, A. (1999). *Our lives: consultation final report* [Jeta jonë: raporti përfundimtar i konsultimit]. Save the Children Scotland Programme.
- Regional Working Group on Child Labour (2001). *Handbook for action-oriented research on the worst forms of child labour and including trafficking in children* [Doracak për hulumtim të orientuar drejt veprimit për format më të këqija të punës së fëmijëve dhe përfshirjen e trafikimit të fëmijëve]. RWG-CL, Bangkok.
- Regional Working Group on Child Labour (2003). *Learning to Work Together: a handbook for managers on facilitating children’s participation to address child labour* [Mësojmë të punojmë së bashku: një doracak për menaxherët për lehtësimin e pjesëmarrjes së fëmijëve për të trajtuar punën e fëmijëve]. Keen Publishing, Bangkok.
- Stephenson, P. (1998a). *From play to participation: Including children in the process of development* [Nga loja te pjesëmarrja: Përfshirja e fëmijëve në procesin e zhvillimit]. Tearfund.

### Lexim i rekomanduar

- Stephenson, P. (1998b). *Our village, our school, our land, our voice: a participatory action research project by Bhima Sangha with Paul Stephenson* [Fshati ynë, shkolla jonë, toka jonë, zëri ynë: një projekt kërkimor për veprim pjesëmarrës nga Bhima Sangha me Paul Stephenson]. Tearfund.
- Tearfund (2004). *Footsteps issue 58: Theatre for development* [Hapat, numri 58: Teatri për zhvillim].
- Yanni, V. (2001). *Community participation with the disabled PLA Notes 42* [Pjesëmarrja e komunitetit me personat me aftësi të kufizuara. Shënimet PLA 42].
- Young, L. dhe Barrett, H. (2001). *Adapting visual methods: Action research with Kampala street children* [Përshatja e metodave vizuale: hulumtim për veprim me fëmijët e rrugës në Kampala]. Royal Geographical Society.
- *A journey in children's participation* (2002) nga Concerned for Working Children, të Reddy N. dhe Ratna K. (red.). "A journey in children's participation". The Concerned for Working Children, Bangalore.
- *Child development study pack* (1999) nga Miles G. dhe Stephenson P., Tearfund.
- *Children at risk guidelines (family breakdown, health, disabilities, sexual abuse, residential care and conflict)* (2001) nga Miles G. dhe Stephenson P., Tearfund.
- *Child-to-child: a practical guide, empowering children as active citizens* (2002) nga Gibbs S.; Mann G. dhe Mathers N., Child-to-Child Trust. Shkarkojeni falas nga [www.child-to-child.org](http://www.child-to-child.org) ose dërgoni email në [ctclondon@yahoo.com](mailto:ctclondon@yahoo.com)
- *Getting the message across* (2001). Regional Working Group on Child Labour, Keen Publishing, Bangkok.  
(Të gjithë librat e botuar nga Regional Working Group mund të porositen falas nga: Child Workers in Asia (CWA), PO Box 29, Chandrakasem Post Office, Bangkok, 10904, Thailand, ose shkarkojini nga [www.seapa.net](http://www.seapa.net))
- *Listening to smaller voices* (1998) nga Johnson V.; Hill J. dhe Ivan-Smith E., ActionAid, London.
- *Participation: Spice it up! Practical tools for engaging children and young people in planning and consultations* (2002) by Dynamix, Save the Children UK.
- *Participatory Learning and Action, Trainers guide* (1995) nga Pretty J. dhe të tjerët. International Institute for Environment and Development. Faqe interneti: [www.iied.org](http://www.iied.org)
- *So you want to consult with children? A toolkit of good practice* (2004). Save the Children Child Participation Working Group, International Save the Children Alliance, London. I disponueshëm në internet në [www.savethechildren.net/alliance/publications](http://www.savethechildren.net/alliance/publications)
- *So you want to involve children in research? A toolkit supporting children's meaningful and ethical participation in research relating to violence against children* (2004). Save the Children Sweden. I disponueshëm në internet në [www.savethechildren.net/alliance/publications](http://www.savethechildren.net/alliance/publications)
- *Stepping forward children and young people's participation in the development process* (1998) nga Johnson V.; Ivan-Smith E.; Gordon G.; Pridmore P. dhe Scott P. (red), Intermediate Technology Publications, London.
- *Training for transformation: a handbook for community workers, librat 1–4* (1999) nga Hope A. dhe Timmel S., Intermediate Technology Publications. Faqe interneti: [www.itdgpublishing.org.uk](http://www.itdgpublishing.org.uk)

### Faqe interneti

- **www.crin.org** *Child Rights Information Network (CRIN)*  
*The Child Rights Information Network* (Rrjeti i Informacionit për të Drejtat e Fëmijëve) është një rrjet global që boton informacion për konventën e të drejtave të fëmijëve dhe të drejtat e fëmijëve për OJQ-të, agjencitë e Kombeve të Bashkuara, institucionet arsimore, si dhe të tjerë ekspertë të të drejtave të fëmijëve.
- **www.cring.org/childrenaspartners** *Children as Partners*  
*Children as Partners* (Fëmijët si Partnerë) është një nismë ndërkombëtare që promovon pjesëmarrjen e ndjeshme të fëmijëve në të gjitha nivelet e vendimmarrjes.
- **www.child-to-child.org** *Child-to-Child Trust*  
Fondacioni *Child-to-Child* (Fëmijë me Fëmijë) është një lëvizje ndërkombëtare punëtorësh dhe programesh shëndetësore dhe arsimore. Ai synon të mbrojë dhe të ruajë shëndetin e komuniteteve duke nxitur dhe aftësuar fëmijët që të luajnë rol aktiv në shëndetin dhe zhvillimin e vetes, fëmijëve të tjerë dhe familjeve të tyre.
- **www.workingchild.org** *The Concerned for Working Children: Working Children's Movement* (Të Shqetësuarit për Fëmijët në Punë: Lëvizja e Fëmijëve në Punë)
- **www.savethechildren.org** *Save the Children Fund*  
Fondi *Save the Children* (Shpëtoni Fëmijët) mbështet punën me fëmijët me bazë të drejtat në mbarë botën. Ai siguron një shumëllojshmëri të gjerë burimesh të shkëlqyera për fëmijët që mund të lexohen përmes faqes së tyre në internet.
- **www.settingthestandard.info**  
Kjo faqe interneti është udhëzues për mbrojtjen e fëmijëve për OJQ-të.
- **www.unicef.org/cre** *UNICEF*  
UNICEF është një agjenci e Kombeve të Bashkuara që përkrah mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për të ndihmuar në përmbushjen e nevojave të tyre bazë dhe për të zgjeruar mundësitë e tyre për të arritur potencialin e plotë. Konventa e Kombeve të Bashkuara "Për të drejtat e fëmijëve" mund të shihet në këtë faqe interneti.
- **www.wvi.org** *World Vision International*  
*World Vision International* është një organizatë e krishterë ndihme dhe zhvillimi që punon për mirëqenien e të gjithë njerëzve, sidomos të fëmijëve. Përmes ndihmave në situata emergjence, arsimit, kujdesit shëndetësor, zhvillimit ekonomik dhe promovimit të drejtësisë, *World Vision* ndihmon komunitetet të ndihmojnë vetveten. Faqja e botimeve të tyre përmban raporte dhe punë kërkimore mbi të drejtat dhe pjesëmarrjen e fëmijëve.



**Mbrojtja e fëmijëve**

(Marrë nga një udhëzues i Tearfund për mbrojtjen e fëmijëve *Everybody's Business* (U përket të gjithëve))

**Shtojca**

Është e rëndësishme që të gjithë anëtarët e stafit dhe të tjerët të kontaktojnë me fëmijët që:

- **të bëhen të ndërgjegjshëm** për situatat që mund të paraqesin rreziqe dhe t'i menaxhojnë;
- **të planifikojnë dhe të organizojnë** punën dhe vendin e punës me qëllim që të minimizojnë rreziqet;
- **të jenë të dukshëm** për të tjerët kur punojnë me fëmijët kurdo që të jetë e mundur;
- **të jenë të hapur** (krijoni dhe ruani një kulturë të hapur ku të mund të diskutohet çdo çështje ose shqetësim);
- **të jenë të përgjegjshëm** ndaj njëri-tjetrit, në mënyrë që të sfidohet çdo sjellje që mund të bëhet abuzive;
- **të zhvillojnë një kulturë** ku fëmijët të mund të flasin hapur për kontaktet e tyre me anëtarë të stafit dhe të tjerë;
- **të respektojnë caqet e çdo fëmije** dhe t'i ndihmojnë ata që të zhvillojnë në vetvete një sens të drejtave të tyre, si dhe t'i ndihmojnë që të dinë se çfarë mund të bëjnë nëse mendojnë se ekziston një problem.

Në përgjithësi, nuk është e përshtatshme që:

- të kaloni shumë kohë vetëm me fëmijët;
- t'i merrni fëmijët në shtëpi, sidomos në vende ku mund të jenë vetëm për vetëm me ju.

Anëtarët e stafit dhe të tjerët **kurrë** nuk duhet:

- të godasin, të sulmojnë apo të abuzojnë fizikisht fëmijët;
- të zhvillojnë marrëdhënie me fëmijët që, në çfarëdolloj mënyre, mund të shihen si shfrytëzim ose abuzim;
- të veprojnë në mënyra që mund të abuzojnë ose mund ta vendosin fëmijën në rrezik abuzimi.

Anëtarët e stafit dhe të tjerët duhet të shmangin veprimet ose sjelljet që mund të shihen si mundësi abuzimi me fëmijën. Për shembull, ata kurrë s'duhet:

- të përdorin fjalor, të bëjnë sugjerime ose të ofrojnë këshilla që janë të papërshtatshme, fyese ose abuzive;
- të sillen fizikisht në mënyra të papërshtatshme;
- të bëjnë që një ose disa fëmijë me të cilët punojnë, të qëndrojnë natën në shtëpinë e tyre pa mbikëqyrjen e të tjerëve;
- të flenë në të njëjtën dhomë ose në të njëjtin shtrat me fëmijën me të cilin punojnë;
- të bëjnë gjëra të një natyre personale për fëmijët, të cilat ata mund t'i bëjnë vetë;
- të justifikojnë ose të marrin pjesë në ato sjellje të fëmijëve që janë të paligjshme, të pasigurta ose abuzive;
- të veprojnë në mënyra që synojnë të shkaktojnë turpërim ose poshtërim;
- të diskriminojnë, të trajtojnë ndryshe ose të favorizojnë disa fëmijë ndërkohë që përjashtojnë të tjerët.



## Shënime

## Shënime